



RAPORT 2021

Shërbimi Social Shtetëror

RAPORT

2021

Janar 2022

TABELA E PËRMBAJTJES

| | |
|--|---------|
| HYRJE | Faqe 3 |
| PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE | Faqe 4 |
| DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESËS SË NE DHE PAK | Faqe 7 |
| DREJTORIA E KOMISIONIMIT TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA | Faqe 22 |
| SEKTORI I AUDITIT TË BRENDSHËM | Faqe 26 |
| DREJTORIA E FINANCËS DHE STATISTIKËS | Faqe 31 |
| DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME | Faqe 42 |
| DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE | Faqe 48 |

HYRJE

Ky raport pasqyron aktivitetin e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror duke përmbledhur edhe aktivitetin e institucioneve të varësisë gjatë vitit 2021. Raporti është i organizuar në formën e një raportimi të detajuar të aktivitetit të çdo Drejtorie në Drejtorinë e Përgjithshme të SHSSH në zbatim të objektivave të institucionit për vitin 2021.

Raportimet për çdo drejtori paraqesin në mënyrë krahasimore veprimtarinë dhe arritjet ndër vite duke evidentuar përmirësimin e dukshëm të performancës së institucionit në të gjithë komponentët e punës së tij:

- Mirëmënaixhimin e skemës së ndihmës ekonomike;
- Modernizimin e skemës së Aftësisë së kufizuar;
- Shërbimet e përkujdesit social;
- Mirëadministrimin financiar dhe të burimeve njerëzore;
- Menaxhimi i kujdesshëm i kërkesave dhe ankesave të njerëzve në të gjitha format e paraqitura, përmes platformës së bashkëqeverisjes, medias, rrjeteve sociale apo direkt pranë zyrave të këtij shërbimi.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

LUNEDA SUFALI

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë vitit 2021 janë arritur shumë rezultate pozitive në lidhje me ndihmën ekonomike, aftësinë e kufizuar dhe shërbimet e përkujdesit shoqëror. Objektivat e vendosura në fillim të vitit ishin në përputhje me detyrat funksionale të strukturave të Shërbimit Social Shtetëror dhe në funksion të arritjes së objektivave strategjike të MSHMS në fushën e mbrojtjes sociale.

Objektivat sipas drejtorive:

Ndihma ekonomike dhe Aftësia e Kufizuar

- Menaxhimi i skemës së ndihmës ekonomike;
- Kontroll mbi zbatimin e legjislacionit për Ndihmën Ekonomike në Drejtoritë Rajonale dhe njësitë vendore;
- Monitorim i skemës dhe orientim drejt tregut të punës për anëtarët në moshë aktive pune për familjet përfituese dhe jopërfituese të NE përmes DRSHSSH në bashkëpunim me administratorët shoqërorë dhe zyrat e punës;
- Kontroll mbi zbatimin e legjislacionit për pagesat PAK në Drejtoritë Rajonale dhe njësitë vendore;

Komisionimet e PAK

- Respektim i legjislacionit gjatë procesit të administrimit dhe komisionimit të PAK;
- Komisionimi bio-psiko-social në qarkun Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Korçë;
- Përgatitjet për shtrirjen e skemës së vlerësimit bio-psiko-social në të gjithë Shqipërinë.

Shërbimet Sociale

- Zhvillimi i shërbimeve shoqërore sipas legjislacionit përkatës;
- Përkujdesje sociale me standarde të përmbushura;
- Përfshirja sociale e grupeve vulnerable;

Shërbimet e brendshme

- Mirëmenaxhim i burimeve njerëzore;
- Ndjekja e ciklit të projekteve;
- Mirëmenaxhim i çështjeve juridike të institucionit;

Financa

- Mirëmenaxhimi i fondeve buxhetore;
- Ndjekja mujore e shpenzimeve me Spitalet që kanë pjesë të aktivitetit të tyre dhe lindjen e bebeve;
- Mirë menaxhimi i aktiveve;
- Transparencë e plotë e shpenzimeve;

Auditi

- Korrupsion zero;

Në mënyrë të përmbledhur veçojmë këto arritje gjatë vitit 2021:

- Është shtrirë me sukses skema e vlerësimit bio-psiko-social në Tiranë, Durrës, Elbasan dhe Korçë.
- Po zhvillohen përgatitjet për shtrirjen e modelit bio-psiko-social në të gjithë Shqipërisë;
- Për herë të parë Shërbimi Social Shtetëror ka aplikuar për një projekt nga Fondet e paraadërimit në BE (IPA), si edhe në bashkëpunim me Shoqatën “Ryder” është implementuar projekti mbi shërbimet në banesë për moshën e tretë.
- Për periudhën Janar-Qershor 2021 kanë përfituar dyfishim të masës së ndihmës ekonomike 70.873 familje;
- Në institucionet e përkujdesit shoqëror publik, rezidenciale dhe ditore kanë marrë shërbim 1140 persona në nevojë.

I. DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESËS SË NE DHE PAK

Objektivat e Drejtorisë së Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK për vitin 2021 kanë qenë të orientuara në 2 drejtimet kryesore: Menaxhimi i skemës së ndihmës ekonomike dhe Kontrolli mbi zbatimin e legjislacionit të ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar.

Gjatë vitit 2021, Drejtoria e Kontrollit të Pagesës së NE dhe PAK, ka funksionuar në bazë të strukturës së SHSSH me dy sektorë: sektori i NE dhe sektori PAK.

I. Rritja e efikasitetit të ndihmës ekonomike

1.1 Monitorimi i skemës së ndihmës ekonomike në nivel kombëtar dhe dinamika e së NE

Gjatë vitit 2021 është monitoruar skema e ndihmës ekonomike çdo muaj nëpërmjet përpunimit të të dhënave statistikore progresive sipas Bashkive dhe Qarqeve duke përfshirë hyrjet e reja dhe arsyet e refuzimit, ndarjen sipas kategorive të përfitimit. Të dhënat statistikore janë dërguar çdo muaj në MSHMS. Gjatë vitit 2021 vihet re një rritje e lehtë e numrit të përfituesve me sistemin e pikëzimit krahasuar me vitin 2020.

Në tabelë pasqyrohet mesatarja vjetore e përfituesve sipas sistemit të pikëzimit 2018, 2019, 2020 dhe 2021.


| Mesatare | Total kategoritë | | Kategoria Familje në Nevojë | | | |
|----------|----------------------|----------------------|-----------------------------|----------------------------------|-------------------------------|------------------------------------|
| | Nr. Aplikimeve total | Nr.përfituesve total | Nr.aplikimeve kategoria NE | Nr.përfituesve familje në nevojë | Refuzuar total (kategoria NE) | Nga këta refuzuar për mospërputhje |
| 2018 | 67258 | 55400 | 65832 | 54060 | 11771 | 4519 |
| 2019 | 67141 | 62002 | 65491 | 60439 | 5052 | 2090 |
| 2020 | 66841 | 62821 | 65248 | 61190 | 3919 | 1927 |
| 2021 | 67648 | 63901 | 65763 | 62120 | 3643 | 1962 |

Ndërsa lidhur me trajtimin e familjeve me fondin deri në 6% mesatarja vjetore për 2021 është 4368 familje më e madhe se mesatarja vjetore e viteve paraardhëse: 2020 është 3700 familje në nevojë, viti 2019 është 3470 familje dhe viti 2018 me 4170 familje.

Skema e NE (pikëzim dhe 6%) për 2021 ka qenë shumë dinamike. Në 6 mujorin e parë ka pasur rritje të numrit të aplikimeve dhe përfituesve për shkak të dyfishimit të masës së ndihmës ekonomike si pasojë e VKM nr. 85, 10.02.2021 me qëllim zbutjen e varfërisë të shkaktuar nga pandemia Covid-19.

Ecuria 2021 Familje në Nevojë, Kategori të veçanta dhe Fondi 6%

| Muaji | Total kategoritë(Familje në nevojë dhe kategori të veçanta) | | | Kategoria Familje në Nevojë | | | | Fondi 6 % | | Total Sistemi i NE + 6% | |
|--------------|--|-----------------------|-------------------|-----------------------------------|------------------------|-------------------------------|------------------------------------|------------------------|------------------|-------------------------|-------------------|
| | Nr. Aplikimeve total | Nr.përfitues ve total | Fond | Nr.përfitues ve familje në nevojë | Nga këto hyrje të reja | Refuzuar total (kategoria NE) | Nga këta refuzuar për mospërpërtje | Nr.familje përfitues e | Fond | Nr. Përfitues ve | Fond |
| Janar | 67433 | 62891 | 649246480 | 61152 | 2564 | 4448 | 2264 | 4143 | 26614892 | 67034 | 675861372 |
| Shkurt | 67431 | 63810 | 655353112 | 62103 | 2091 | 3507 | 1476 | 4316 | 27495976 | 68126 | 682849088 |
| Mars | 68825 | 65525 | 673250072 | 63786 | 2424 | 3220 | 1175 | 4556 | 29244456 | 70081 | 702494528 |
| Prill | 70954 | 66579 | 683458420 | 64799 | 2484 | 4297 | 2031 | 4481 | 28559008 | 71060 | 712017428 |
| Maj | 70137 | 66603 | 683475672 | 64823 | 1378 | 3437 | 1638 | 4427 | 27870272 | 71030 | 711345944 |
| Qershor | 69887 | 66481 | 675334756 | 64661 | 1195 | 3312 | 1643 | 4392 | 27503084 | 70873 | 702837840 |
| Korrik | 69190 | 64723 | 343980655 | 62935 | 1057 | 4331 | 2895 | 4339 | 14167232 | 69062 | 358147887 |
| Gusht | 67108 | 64132 | 340547894 | 62343 | 852 | 2874 | 1610 | 4319 | 14112896 | 68451 | 354660790 |
| Shtator | 66668 | 63571 | 349037589 | 61789 | 942 | 2982 | 1717 | 4391 | 14432548 | 67962 | 363470137 |
| Tetor | 66073 | 61399 | 332405300 | 59612 | 942 | 4546 | 3245 | 4297 | 14122808 | 65696 | 346528108 |
| Nëntor | 64751 | 60676 | 329157792 | 58855 | 1242 | 3948 | 2319 | 4388 | 14490036 | 65064 | 343647828 |
| Dhjetor | 63319 | 60417 | 327377559 | 58579 | 1071 | 2812 | 1529 | | | 60417 | 327377559 |
| Total | | | 6042625301 | | | | | | 238613208 | | 6281238509 |



Të dhënat që raportohen për fondin deri në 6% janë të dhëna të cilat gjenerohen nga Regjistri Elektronik Kombëtar. Në tabelë mungon numri i familjeve që trajtohen me fondin deri në 6% për muajin Dhjetor, pasi kjo procedurë bëhet në muajin pasardhës (Janar 2022).

Gjatë vitit 2021, me qëllim zbutjen e efekteve të shkaktuara nga epidemia Covid-19, për t'i ardhur në ndihmë shtresave në nevojë, u miratua me vendim të Këshillit të Ministrave dyfishimi i masës për të gjithë përfituesit e ndihmës ekonomike.

1. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 85, datë 10.02.2021, Për një shtesë në vendimin Nr.597, datë 04.09.2019 të Këshillit të Ministrave “ Për përcaktimin e procedurave , dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike, përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” Kreu III, pika “15. Për përfituesit e ndihmës ekonomike, të përcaktuar në shkronjat “a”, “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të pikës 2, të kreut I, të këtij vendimi, masa e ndihmës ekonomike dyfishohet për një periudhë 6-mujore, me qëllim zbutjen e efekteve të shkaktuara nga epidemia COVID-19.”.

Për periudhën Janar, Shkurt, Mars, Prill, Maj dhe Qershor 2021 kanë përfituar dyfishim të masës së ndihmës ekonomike 70.873 familje (familje përfituese me sistemin e pikëzimit+familje të trajtuara me fondin 6%) me fond 702.837.840 lekë.

2. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 257, datë 05.05.2021, “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të Asistencës Sociale”, solli shfuqizimin e VKM-së Nr.566, datë 29.9.2018 “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të veprimtarisë e të zbatimit të legjislacionit për ndihmën ekonomike dhe aftësinë e kufizuar në strukturat e varësisë së shërbimit social shtetëror dhe pranë njësisive të vetëqeverisjes vendore”. Konceptet e inkorporuara në këtë vendim janë si më poshtë:

- Kontrolli i legjislacionit të ndihmës sociale do të kryhet sipas procedurave të përcaktuara në këtë vendim, bazuar tek Shtojca Nr.1 “Metodologjia e kontrollit të ndihmës ekonomike” si dhe Shtojca Nr.2 “Metodologjia e kontrollit të vlerësimit Bio-Psiko-Social të aftësisë së kufizuar”, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi (pika 1 e VKM-së).
- Për shkelje të legjislacionit të NE dhe marrjen e masave të nevojshme për parandalimin, zbulimin, raportimin dhe menaxhimin e mashtrimit dhe korrupsionit do të zbatohet Shtojca Nr. 3 “Mekanizmat e standartizuar të raportimit për monitorimin e abuzimeve dhe korrupsionit në skemën e ndihmës ekonomike”, që i bashkëlidhet këtij vendimi (pika 10 e VKM-së).
- Performanca e strukturave rajonale të SHSSH në kryerjen e kontrollit të NE në njësitë e vetëqeverisjes vendore do të kryhet përmes: i. Cilësisë së projekt/raporteve sipas zbatimit të hapave të përcaktuara në metodologjinë e kontrollit, ii. Ndjekjes së zbatimit të detyrave të lëna lidhur me shpërblimin e dëmit dhe raportimin 6 mujor pranë SHSSH, iii. Analizës së riskut të kontrollit tematik në njësitë vendore.
- Në vendim është përfshirë kontrolli i zbatimit të legjislacionit për vlerësimin Bio-Psiko-Social në nivel qendror (pika 12) dhe vlerësimi Bio-Psiko-Social nga ana e strukturave rajonale (pika 13).
- Raportet përfundimtare të hartuara për kontrollet e aftësisë së kufizuar sipas pikës 12 të këtij vendimi do të paraqiten drejtorit rajonal të Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor dhe drejtorit të përgjithshëm të Operatorit të Operatorit të Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor (pika 16 e VKM-së).

- Në VKM- në Nr.257/2021 është kryer një riorganizim lidhur me masat për shkeljet e konstatuara gjatë kontroleve dhe personat përgjegjës ku përveç strukturave rajonale të shërbimit social, strukturave përgjegjëse për shërbimet sociale në bashki dhe administratorëve shoqëror janë përcaktuar si persona përgjegjës edhe mjekët e familjes dhe mjekët specialistë.

2. Konsolidimi i skemës së ndihmës ekonomike me anë të mirëadministrimit të Regjistrimit Elektronik Kombëtar dhe sistemit të pikëzimit.

- Shtimi i dyfishimit të masës së Ndihmës Ekonomike për periudhën Shkurt-Qershor 2021 në sistemin e NE, masa e dyfishuar gjenerohet nga sistemi (muaji Janar 2021 shtesa është marrë jashtë sistemit, me bordero të veçantë).
- Përmirësim i raportit të statistikave mujore.
- Përmirësim në formatin e projektit-raportit dhe raportit përfundimtar, në modulën e kontrollit.
- Përmirësime në raportin anëtarë në moshë aktive të familjeve përfituese duke bërë të mundur shtimin e disa filtrave të tjerë.
- Ndjekja e problematikave teknike të sistemit të NE nëpërmjet portalit të suportit.
- Për periudhën prill-shtator verifikimi me AKPA (Agiencinë Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive) është kryer dhe manualisht, për shkak të implementimit të sistemit të ri nga ana e tyre.

2.1 Mirëadministrimi i Regjistrimit Elektronik të Ndihmës ekonomike duke integruar për fondin deri në 6%.

- Disa përmirësime në raportin e fondit të 6 %.
- Ndjekja e problematikave teknike të sistemit të NE nëpërmjet portalit të suportit.

2.2 Monitorim i Drejtorive Rajonale lidhur me objektivin për orientimin drejt tregut të punës si dhe punësimet e anëtarëve në moshë aktive pune të përfituesve të NE-së.

Bazuar në VKM-në Nr. 882, datë 24.12.2019 “Për mekanizmin e bashkërendimit ndërinstitucional të punës për referimin për punësim të individëve dhe anëtarëve në moshë aktive pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike” si dhe në marrëveshjen nr.308, datë 15.02.2018 “Për punësimin dhe integrimin në tregun e punës të anëtarëve në moshë aktive pune të cilët janë përfitues të skemës së ndihmës ekonomike”, është kryer koordinim dhe bashkëpunim i ndërsjellë midis Shërbimit Social Shtetëror dhe Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive. Brenda këtij kuadri ligjor, SHSSH i siguron AKPA-së të dhënat për anëtarët në moshë pune të familjeve përfituese të skemës së ndihmës ekonomike përmes Regjistrimit Elektronik Kombëtar të NE-së dhe listave mujore të dërguara nga 12 DRSSHSH, ndërsa AKPA i siguron SHSSH-së informacion mujor lidhur me të dhënat mbi anëtarët në moshë pune të familjeve përfituese të skemës së ndihmës ekonomike të cilët janë punëkërkues aktivë dhe iu është ofruar shërbim në sportelet e zyrave të punësimit, janë pjesëmarrës në kurset e formimit profesional, janë ç’regjistruar për arsye punësimi/përfshirë pjesëmarrjen në programet e nxitjes së punësimit apo kanë humbur statusin e punëkërkuesit

të papunë për arsye të refuzimit të shërbimeve dhe programeve të ofruara nga zyra e punësimit, përmes ndërveprimit të sistemit të shërbimit të punësimit të AKPA-së me sistemin e NE-së.

Nga bashkëpunimi i deri tanishëm, ky koordinim është kryer nga Drejtoritë Rajonale të SHSSH me Drejtoritë Rajonale të AKPA, por me mangësi dhe mosrakovim të dhënash. Kjo problematikë lidhet edhe me implementimin e sistemit të ri të shërbimit të punësimit të AKPA-së gjatë periudhës Prill-Tetor 2021, e cila solli vështirësi në identifikimin e punëkërkuësve aktive përfitues nga skema e NE-së.

Nga të dhënat e vitit 2021 janë raportuar 861 të punësuar krahasuar me vitin 2020 ku kanë qenë 669 anëtarë të punësuar të familjeve të NE-së. Lidhur me numrin e anëtarëve të familjeve të ndihmës ekonomike të orientuar drejt formimit profesional vihet re një rritje, pasi raportohen 383 anëtarë të orientuar drejt kursit të formimit profesional krahasuar me 153 anëtarë në vitin 2020.

Të dhënat e raportuara nga Drejtoritë Rajonale në bashkëpunim me zyrat e punës në kuadër të planit operacional për punësimin e anëtarëve aktivë në moshë pune, përfitues të skemës së ndihmës ekonomike për periudhën Janar – Nëntor 2021 janë si më poshtë vijon:

| Qarku | Të punësuarit Janar- Nëntor | Nr. personave në formim profesional Janar-nëntor |
|-------------|--------------------------------|--|
| Berat | 34 | 0 |
| Diber | 130 | 12 |
| Durrës | 43 | 0 |
| Elbasan | 125 | 164 |
| Fier | 45 | 10 |
| Gjirokastër | 14 | 12 |
| Korçë | 118 | 8 |
| Kukës | 117 | 44 |
| Lezhë | 35 | 2 |
| Shkodër | 47 | 47 |
| Tiranë | 98 | 84 |
| Vlorë | 55 | 0 |
| Total | 861 | 383 |

3. Zbatimi i legjislacionit për ndihmën ekonomike dhe pagesat PAK nëpërmjet kontrolleve të ushtruara pranë njësive vendore.

Drejtorja e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK dhe 12 Drejtoritë Rajonale kanë hartuar planin vjetor të kontrolleve për ndihmën ekonomike për vitin 2021 nëpërmjet modulit të kontrollit në sistem dhe kontrolle për zbatimin e legjislacionit të pagesave të PAK dhe invalidëve të punës.

Janë kontrolluar për vitin 2021: 251 njësi vendore dhe janë konstatuar 1086 familje që kanë përfituar në kundërshtim me legjislacionin me dëm ekonomik 11.304.300 lekë dhe 367 familje PAK me dëm ekonomik 12.272.564 lekë dhe invalid pune 278 me dëm ekonomik 1.688.722 lekë. Janë propozuar gjithsej 217 masa: 150 raste shpërblim dëmi, 58 masë administrative dhe 9 raste gjobë.

Qarqet Dibër, Lezhë, Fier dhe Kukës janë Qarqet në të cilat janë konstatuar problematika të ndryshme në lidhje me familjet të cilat kanë përfituar në kundërshtim me legjislacionin që lidhen me:

- Pagesa e padrejtë në strukturën e familjes në raste ku ka pasur anëtarë të familjes PAK (nuk checkohet pyetja në sistem),
- Familje që trajtohen me fondin deri në 6% pa përmbushur kriteret.
- Mosfirmosje të deklaratave 3-mujore nga të gjithë anëtarët madhorë të familjes
- Mosplotësimi i saktë i formularit të aplikimit nga administratori shoqëror.
- Moskryerja e vizitës fillestare brenda muajit për familjet që aplikojnë për herë të parë dhe dy herë në vit për familjet ekzistuese në skemën e ndihmës ekonomike.
- Mosarkëtimi i shumave të përfituara padrejtësisht dhe në kundërshtim me ligjin
- Nuk trajtoheshin mospërputhjet lidhur me vizitat në shtëpi, me “Jetimët që nuk janë në Institucion” dhe “Prindërit e fëmijëve të lindur me më shumë se 2 fëmijë njëherësh”

Tabela përmbledhëse e kontrolleve për periudhën Janar-Dhjetor 2021 në 12 Qarqe.

Tabela e Kontrollleve për Vitin 2021

| QARKU | Njësi/ad | Numri i Familjeve në NE | Numri i dosjeve të kontrolluara | Numri i verifik. social ekonomike | Mashttrim | | Gabim | | Dëmi Ekonomik | | Numri i Personave me PAK | Nr.Pers onave abuziv PAK | Dëmi Ekonomik | Nr Invalid/Punës | Nr Per/abuziv | Dëmi Ekonomik | Total Dëmi ekonomik NE-PAK/Invaliditet | MASA |
|-------------------------|----------------------|-------------------------|---------------------------------|-----------------------------------|------------|----------------|------------|----------------|---------------|-----------------|--------------------------|--------------------------|-----------------|------------------|---------------|----------------|--|--|
| | | | | | Nr. Fam | Fond | Nr. Fam | Fond | Nr. Fam | Fond | | | | | | | | |
| TIRANË | 23 KONTROLLE | 2327 | 941 | 0 | 0 | 0 | 8 | 401760 | 8 | 401760 | 5940 | 74 | 1072029 | 7532 | 19 | 151800 | 1625589 | 5 MASA GJITHSEJ (2 MASA DISIPLINORE+3 SHPËRBLIME DËMI) |
| DURRËS | 11 KONTROLLE | 719 | 398 | 306 | 4 | 0 | 9 | 69240 | 13 | 69240 | 3210 | 21 | 1682471 | 2743 | 52 | 393312 | 2145023 | 10 MASA GJITHSEJ (8 SHPËRBLIME DËMI+2 MASA DISIPLINORE) |
| ELBASAN | 30 KONTROLLE | 9037 | 2540 | 163 | 64 | 690084 | 9 | 121320 | 73 | 811404 | 5364 | 8 | 91879 | 3663 | 8 | 52800 | 956083 | 36 MASA GJITHSEJ (33 SHPËRBLIME DËMI+3 MASA DISIPLINORE) |
| KORÇË | 18 KONTROLLE | 3837 | 1245 | 103 | 0 | 0 | 52 | 794872 | 52 | 794872 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 794872 | 8 MASA GJITHSEJ (6 SHPËRBLIME DËMI+2 MASA DISIPLINORE) |
| VLORË | 23 KONTROLLE | 1659 | 1659 | 128 | 0 | 0 | 29 | 319092 | 29 | 319092 | 2550 | 23 | 1431133 | 3796 | 8 | 114900 | 1865125 | 18 MASA GJITHSEJ (10 SHPËRBLIME DËMI+8 MASA DISIPLINORE) |
| LEZHË | 13 KONTROLLE | 1486 | 781 | 38 | 0 | 0 | 19 | 171136 | 19 | 171136 | 2721 | 6 | 771404 | 2705 | 1 | 3300 | 945840 | 7 MASA GJITHSEJ (6 SHPËRBLIME DËMI+1 MASË DISIPLINORE) |
| GJIROKASTËR | 16 KONTROLLE | 746 | 870 | 0 | 9 | 408020 | 22 | 719932 | 31 | 1127952 | 1533 | 19 | 1835807 | 1853 | 8 | 59400 | 3023159 | 13 MASA GJITHSEJ (13 SHPËRBLIME DËMI) |
| SHKODËR | 24 KONTROLLE | 2372 | 1109 | 59 | 0 | 0 | 331 | 3152248 | 331 | 3152248 | 3168 | 92 | 2615742 | 1417 | 41 | 273400 | 6041390 | 55 MASA GJITHSEJ (36 SHPËRBLIME DËMI +7 GJOBA +12 MASA DISIPLINORE) |
| FIER | 20 KONTROLLE | 974 | 432 | 77 | 0 | 0 | 28 | 508716 | 28 | 508716 | 2563 | 4 | 213372 | 1950 | 2 | 56210 | 778298 | 3 MASA GJITHSEJ (3 SHPËRBLIME DËMI) |
| KUKËS | 19 KONTROLLE | 4546 | 1634 | 10 | 84 | 1629340 | 26 | 316468 | 110 | 1945808 | 1071 | 25 | 906021 | 1208 | 3 | 52200 | 2904029 | 17 MASA GJITHSEJ (16 SHPËRBLIME DËMI+1 MASË DISIPLINORE) |
| DIBËR | 32 KONTROLLE | 9762 | 1924 | 395 | 0 | 0 | 319 | 963446 | 319 | 963446 | 3232 | 83 | 587854 | 2504 | 87 | 326300 | 1877600 | 39 MASA GJITHSEJ (15 SHPËRBLIME DËMI+ 24 MASA DISIPLINORE) |
| BERAT | 22 KONTROLLE | 1494 | 1960 | 131 | 12 | 202816 | 61 | 835810 | 73 | 1038626 | 2569 | 12 | 1064852 | 2525 | 49 | 205100 | 2308578 | 6 MASA GJITHSEJ (3 MASA DISIPLINORE+2 GJOBA+1 SHPËRBLIM DËMI) |
| TOTALI 12 QARQET | 251 KONTROLLE | 38959 | 15493 | 1410 | 173 | 2930260 | 913 | 8374040 | 1086 | 11304300 | 33921 | 367 | 12272564 | 31896 | 278 | 1688722 | 25265586 | 217 MASA GJITHSEJ (150 SHPËRBLIME DËMI+58 MASA DISIPLINORE+9 GJOBA) |

Kontrolle të kryera nga Drejtoria e Kontrollit të Pagesës së NE dhe PAK/Sektori NE

Në bazë të planit vjetor të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, për periudhën Janar-Dhjetor 2021 janë planifikuar 8 kontrolle gjithsej, ku rezultoi se 6 janë kontrolle të plota në Drejtorinë Rajonale Gjirokastrë, Tiranë, Shkodër, Berat, Lezhë dhe Fier si dhe 2 kontrolle tematike në Drejtorinë Rajonale Dibër dhe Kukës. Kontrollat janë kryer si më poshtë:

Kontrollet e plota kanë qenë: në muajin Shkurt Drejtoria Rajonale Gjirokastrë, në muajin Maj Drejtoria Tiranë, në muajin Qershor Drejtoria Shkodër, në muajin Korrik Drejtoria Berat, në muajin Shtator Drejtoria Lezhë dhe në muajin Nëntor Drejtoria Fier, si dhe dy kontrollet tematike të kryera në muajin Mars Drejtoria Rajonale Dibër dhe në muajin Nëntor Drejtoria Rajonale Kukës. Verifikimet për kontroll janë kryer nëpërmjet Regjistrimit Elektronik Kombëtar dhe të dhënave që Drejtorinë Rajonale disponojnë.

Nga kontrolli i ushtruar në 8 Drejtorinë Rajonale janë konstatuar problematika si më poshtë:

- Plani vjetor nuk është zbatuar plotësisht nga të gjitha Drejtorinë Rajonale për vitin 2021.
- Specialistët në Drejtorinë Rajonale i kanë zbatuar pjesërisht detyrat dhe përgjegjësitë e strukturës kontrolluese në përputhje me përcaktimet e bëra në zbatim të VKM-së 257, datë 05.05.2021 “Për procedurat e kryerjes së kontrollit të zbatimit të legjislacionit të Asistencës Sociale ”Shtojca Nr.1” Metodologjia e Kontrollit Të Ndhmës Ekonomike ”, për kontrollet që janë realizuar, pjesa e gjetjeve nuk ka qenë e detajuar në të gjitha rastet duke i identifikuar familjet/individët të cilët janë përfitues ose kanë përfituar padrejtësisht në kundërshtim me ligjin. Kontrollat nuk kanë qenë të plota një herë në dy vjet në të gjitha njësitë e vetqeverisjes vendore.
- Lidhur me kontrollin e zbatimit të detyrave të lëna nga Drejtoria e Kontrollit të Pagesës së NE dhe PAK por edhe nga detyrat e lëna nga Drejtorinë Rajonale në Njësi/Bashki është konstatuar se detyrat nuk janë realizuar plotësisht, nuk është ndjekur ecuria e familjeve përfituese në skemën e ndihmës ekonomike të cilat kanë përfituar në kundërshtim me ligjin.
- Bazuar planit vjetor të punës për 8 kontrollet e kryera nga Drejtoria e Pagesave të NE dhe PAK, është konstatuar se dëmi financiar i shkaktuar për vitin 2021 arrin në masën 1.049.633lekë. Janë identifikuar gjithsej 38 familje, ku 36 familje rezultojnë me gabim dhe 2 familje me mashtrim të cilat kanë përfituar në kundërshtim me ligjin.
- Arkëtimet për vitin 2021 janë në total 3.619.316 lekë, përkatësisht janë arkëtuar nga Drejtoria Fier 365.712 lekë, Drejtoria Kukës 37.320 lekë, Drejtoria Lezhë 148.920 lekë, Drejtoria Berat 868.693 lekë, Drejtoria Shkodër 1.556.766 lekë, Drejtoria Gjirokastrë 530.619 lekë, Drejtoria Dibër 111.286 lekë dhe Drejtoria Tiranë nuk ka pasur asnjë arkëtim për periudhën Janar- Dhjetor 2021.
- Referuar raporteve nga sistemi i ndihmës ekonomike dhe vendimit final të Drejtorive Rajonale rezultoi se numri i përfituesve në të gjithë Qarqet ka qenë në rritje nga viti 2020 në vitin 2021.

- Gjatë kontrolleve janë konstatuar se gjatë verifikimeve në sistem vizitat janë kryer me vonesë, nuk janë kryer brenda muajit të parë të aplikimit për familjet që aplikojnë për herë të parë si dhe dy herë në vit për familjet përfituese me ndihmë ekonomike.
- Janë konstatuar raste ku administratorët shoqërorë nuk kanë plotësuar saktë formularin e vizitës në familje sipas të gjitha rubrikave përkatëse dhe ka pasur probleme me hedhjen në sistem. Në rastet kur ka ndryshime duhet të çekohet pyetja “po” ka ndryshime nga deklarimi gjatë hedhjes në sistem të vizitës në familje dhe pasqyrimi i të gjitha ndryshimeve me qartësi dhe korrektësi.
- Referuar verifikimeve në rubrikën e vizitës në shtëpi ka rezultuar se procedura e ndjekur nga ana e administratorëve shoqërorë për vizitat e kryera në banesë nuk ka qenë e saktë në 2 Qarqet Lezhë dhe Kukës. Të gjitha ndryshimet social ekonomike që ndodhin tek familjet përfituese, të cilat sipas VKM-së Nr.597/2019, Kreu II, pika 4 duhet të deklarohen në deklaratat 3 mujore që plotësohen pranë administratorit shoqëror nga anëtarët madhor të familjes, në praktikë deklarohen tek vizitat në banesë, duke ndryshuar në këtë mënyrë edhe qëllimin e vizitave në familje të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.
- Verifikimet automatike të pensioneve, janë konstatuar raste në të gjitha Qarqet në lidhje me mosçekimin e pyetjes: A përfiton pagesë të aftësisë së kufizuar/pension invaliditeti ndonjë nga anëtarët e familjes? Në mënyrë që të përcaktohet saktë masa e përfitimit të ndihmës ekonomike, familjet/individët kanë deklaruar masën që përfitojnë si kategori e PAK/Invaliditeti por nga ana e administratorit shoqëror nuk është çekuar pyetja dhe si pasojë nuk i është zbritur masa e përfituar padrejtësisht duke shtuar edhe efektet financiare.
- Nga Drejtoritë Rajonale nuk është kryer kontroll i detajuar mbi planifikimin e fondeve, procedurën e ndjekur ndërmjet Bashkisë dhe Postës/Bankës për rakordimin, përputhjen midis fondit të planifikuar, atij të shpërndarë dhe gjendjen faktike. Rezulton se nga ana e Drejtorive Rajonale nuk është zbatuar ndjekja dhe realizimi i fondeve në të gjitha Njësitë pasi nga ana e Postës/Bankës nuk janë disponuar akt rakordime dhe borderotë/lista emërore e familjeve.
- Gjatë kontrolleve të kryera janë vënë re shumë pasaktësi nga ana e administratorve në plotësimin e aplikimeve për ndihmën ekonomike. Në lidhje me procedurën e ndjekur nga administratori shoqëror për plotësimin e formularëve të aplikimit nga verifikimi ka rezultuar se të dhënat e pasqyruara në formular sikurse është deklarimi i pagave, masa e pagave të deklaruara në ditë apo muaj, totali i të ardhurave për familjen, masa e saktë e pensionit që merr, asetet që zotëron familja nuk janë të sakta.
- Lidhur me kategorinë “Jetimët që nuk janë në institucion”, nga kontrollat e kryera në 8 Drejtoritë Rajonale për vitin 2021 rezulton se jo të gjitha Drejtoritë i kanë trajtuar mospërputhjet e ardhura nga Institucionet.

- Referuar kategorive “Prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh, që u përkasin familjeve në nevojë” rezulton se nga kontrolli i kryer janë identifikuar familje të kategorisë “prindërit me më shumë se 2 fëmijë të lindur njëherësh”, për të cilat nuk janë trajtuar mospërputhjet e ardhura nga institucionet me të cilat kryqëzohet informacioni, si dhe administratorët shoqëror nuk kanë kryer verifikimin social ekonomik në banesë sipas VKM-së Nr.597, Kreu I, pika 4.3.
- Në lidhje me verifikimet manuale është konstatuar se nga ana e Drejtorive Rajonale shkresat janë dërguar institucioneve çdo muaj për konfirmim. Gjatë kontrolleve ka rezultuar se disa nga Insitucionet kanë kthyer përgjigje, pjesa tjetër kanë qenë formale si përgjigje dhe jo duke ju referuar informacionit të kërkuar si dhe Agjensia Shtetërore e Kadastrës që nuk ka kthyer përgjigje pasi Zyrat Vendore me anë të shkresave zyrtare kanë vënë në dijeni Drejtoritë Rajonale se informacioni i kërkuar jepet kundrejt tarifave përkatëse.
- Gjatë kontrolleve janë konstatuar raste ku familje/individë përfitues në skemën e ndihmës ekonomike, dispononin mjete motorrike të viteve 2001-2021 si dhe gjatë qëndrimit në skemën e ndihmës ekonomike kanë blerë mjet motorrik të dytë pa deklaruar burimin e të ardhurave për blerjen e mjetit si dhe pa e deklaruar atë pranë administratorit shoqëror.
- Në lidhje me zbatimin e penaltitve 6 mujore dhe 1 vjeçare rezultoi se gjatë kontrolleve të kryera, janë konstatuar raste ku familje/individë janë refuzuar nga skema e ndihmës ekonomike për deklaram të rremë, janë lejuar te riaplikojnë gjatë periudhës së penaltetit nga administratorët shoqëror dhe nuk janë verifikuar nga ana e Drejtorisë Rajonale, kjo në kundërshtim me Ligjin 57/ date 18.07.2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”.

Referuar të dhënave më sipër për çdo problematikë të konstatuar gjatë kontrollit nga Drejtoria e Kontrollit të Pagesës së NE dhe PAK, janë lënë detyra dhe janë vendosur masa administrative në bazë të legjislacionit në fuqi.

Kontrolle të kryera nga Drejtoria e Kontrollit të Pagesës së NE dhe PAK/ Sektori PAK

Gjatë vitit 2021 sipas planit të punës janë kontrolluar 4 Komisione Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Tiranë, përkatësisht:

1. Në Komisionin Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar pranë *Spitalit Kavajë* ku marrin shërbim bashkia Kavajë dhe Rrogazhinë dhe njësitë administrative Golem, Gosë, Helmës, Kryevidh, Lekaj, Luz i Vogël, Sinaballaj dhe Synej.

Janë kontrolluar 30 dosjeve fizike që i pëkasin skemës së vjetër të personave me aftësi të kufizuar pranë këtij Komisioni ku u konstatua se në gjitha dosjet ndodhet karta e identitetit (certifikata personale), formulari i aplikimit, mjekut të familjes, mjekut specialist dhe formulari i vlerësimit. Gjithashtu ndodheshin dhe dokumentacionet dhe ekzaminimet mjekësore përkatëse sipas diagnozave të përcaktuara në Udhëzuesin e Vlerësimit Bio-Psiko-social për të rritur dhe fëmijë.

Nga verifikimi elektronik i informacionit në Regjistrin Elektronik Kombëtar në zbatim të VKM Nr.722, datë 11.11.2019, kreu III, pika 4, gërma c në lidhje me ISSH dhe DPT u konstatua se me Institutin e Sigurimeve Shoqërore nuk ka përgjigje positive kurse me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve rezulton se ka përgjigje positive për 7 përfitues por verifikuesi nuk i ka s'kualifikur pasi janë përfitues sipas skemës së vjetër të vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe përfitues të rregullt sipas legjislacionit në fuqi.

Nga verifikimi elektronik i informacionit në Regjistrin Elektronik Kombëtar për muajin dhjetor 2020 mbi respektimin e afateve të kontrollit mjekësor vjetor (dorëzimi i formularit nr.8) nuk kanë dorëzuar formularin e kontrollit vjetor 5 aplikantë, kjo në kundërshtim me VKM Nr.722, datë 11.11.2019, kreu III, pika 4, çështja g.

Nga kontrolli i kartelave të mjekut specialist na rezulton se ka ndryshime të përcaktimit të nivelit të dëmtimit midis mjekut specialist dhe komisionit shumëdisiplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, në shumë nga këto raste të verifikuara niveli i dëmtimit i përcaktuar nga komisionit shumëdisiplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar është më i ulët se niveli i dëmtimit të përcaktuar nga mjeku specialist e verifikur kjo nga regjistri elektronik PAK.

2. Në Komisionin Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar pranë *Qendrës së Zhvillimit Kombinat* ku marrin shërbim njësitë administrative Nr.6, Nr.7, Kashar, Vaqarr dhe Ndroq.

Janë kontrolluar 30 dosjeve fizike nga këto 11 dosje për herë të parë dhe 19 dosje nga skema e vjetër të personave me aftësi të kufizuar pranë këtij Komisioni ku u konstatua se në gjitha dosjet ndodhet karta e identitetit (certifikata personale), formulari i aplikimit, mjekut të familjes, mjekut specialist dhe formulari i vlerësimit. Gjithashtu ndodheshin dhe dokumentacionet dhe ekzaminimet mjekësore përkatëse sipas diagnozave të përcaktuara në Udhëzuesin e Vlerësimit Bio-Psikosocial për të rritur dhe fëmijë.

Nga verifikimi elektronik i informacionit në Regjistrin Elektronik Kombëtar në zbatim të VKM Nr.722., datë 11.11.2019, kreu III, pika 4, gërma c në lidhje me ISSH dhe DPT u konstatua se me Institutin e Sigurimeve Shoqërore ka përgjigje për 4 përfitues kurse me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve rezulton se ka përgjigje positive për 63 përfitues. Pas verifikimeve në Regjistrin Elektronik Kombëtar u konstatua se 52 persona janë përfitues sipas skemës së vjetër të vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe përfitues të rregullt sipas legjislacionit në fuqi dhe 11 persona kanë në dosjet e tyre dokumente zyrtare nga DPT që nuk janë përfitues nga skema e tyre, kjo e shoqëruar me dokument zyrtar.

Nga verifikimi elektronik i informacionit në Regjistrin Elektronik Kombëtar për muajin dhjetor 2020 mbi respektimin e afateve të kontrollit mjekësor vjetor (dorëzimi i formularit nr. 8) nuk kanë dorëzuar formularin e kontrollit vjetor mjekësor 14 aplikantë kjo në kundërshtim me VKM Nr.722, datë 11.11.2019, kreu III, pika 4, çështja g .

Mjeku specialist dhe mjeku i familjes duhet të përcaktoje diagnozën sipas udhëzuesit bio-psiko-social të mbështetur në dokumentacionin mjekësor dhe ekzaminimet mjekësore perkatatëse, gjithashtu duhet të përcaktojë nivelin e vështirësisë në bazë të konsultave mjekësore, ekzaminimeve përkatëse dhe ndjekjes në vazhdimësi të pacientit, kjo e dokumentuar në kartelën mjekësore. Nga kontrolli i 30 kartelave mjekësore të mjekëve specialistë na rezultoi se mungonin kartetat për 2 raste.

3. Në Komisionin Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar pranë ***Qendrës Shëndetësore Nr.10*** marrin shërbim njësitë administrative Nr.3, Nr.4, Dajt, Farkë, Pezë, Shëngjergj, Zall-Herr dhe Zall-Bastar.

Janë kontrolluar 34 dosjeve fizike nga këto 6 dosje për herë të parë dhe 28 dosje nga skema e vjetër të personave me aftësi të kufizuar pranë këtij Komisioni ku u konstatua se në gjitha dosjet ndodhet karta e identitetit (certifikata personale), formulari i aplikimit, mjekut të familjes, mjekut specialist dhe formulari i vlerësimit. Gjithashtu ndodheshin dhe dokumentacionet dhe ekzaminimet mjekësore përkatëse sipas diagnozave të përcaktuara në Udhëzuesin e Vlerësimit Bio-Psikosocial për të rritur dhe fëmijë.

Nga verifikimi elektronik i informacionit në Regjistrin Elektronik Kombëtar në zbatim të VKM Nr.722, datë 11.11.2019, kreu III, pika 4, gërma c në lidhje me ISSH dhe DPT. Nga verifikimet automatike në sistem me DPT rezultoi se sipas sistemit 58 përfitues kanë shkëlje. Pas verifikimeve në Regjistrin Elektronik Kombëtar u konstatua se 51 persona janë përfitues sipas skemës së vjetër të vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe përfitues të rregullt sipas legjislacionit në fuqi dhe 7 persona kanë në dosjet e tyre dokumente zyrtare nga ISSH që nuk janë përfitues nga skema e tyre, kjo e shoqëruar me dokument zyrtar.

Nga verifikimet e kryera në Regjistrin Elektronik Kombëtar për muajin Dhjetor 2020 dhe Janar 2021 na rezultoi se duhet të dorëzohen formularin e kontrollit vjetor, 30 aplikantë, nga të cilët vetëm 18 aplikantë kanë dorëzuar formularin e kontrollit vjetor mjekësor dhe 12 aplikantë nuk e kanë dorëzuar.

Nga kontrolli na rezulton se ka ndryshime të përcaktimit të nivelit të dëmtimit midis mjekut specialist dhe komisionit shumëdisiplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, në shumë nga këto raste të verifikuara niveli i dëmtimit i përcaktuar nga komisionit shumëdisiplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar është më i ulët se niveli i dëmtimit të përcaktuar nga mjeku specialist e verifikur kjo nga regjistri elektronik PAK. Nga kontrolli i 34 kartelave mjekësore të mjekëve specialistë na rezultoi se kartelat ishin të gjitha të plotësuara.

4. Në Komisionin Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar pranë **Poliklinikës së Specialiteteve Nr.1 Tiranë** marrin shërbim njësitë administrative Nr.1, Nr.2, Nr.5, Baldushk, Bërzhull dhe Krrabë.

Janë kontrolluar 49 dosjeve fizike nga këto 19 dosje për herë të parë dhe 30 dosje nga skema e vjetër të personave me aftësi të kufizuar pranë këtij Komisioni ku u konstatua se në gjitha dosjet ndodhet karta e identitetit (certifikata personale), formulari i aplikimit, mjekut të familjes, mjekut specialist dhe formulari i vlerësimit. Në disa prej dosjeve të kontrolluara mungon një pjesë e dokumentacionit mjekësor të kërkuar sipas Udhëzuesit për Vlerësimin Bio-Psikosocial. Kjo në kundërshtim me Urdhërin nr. 225, datë 06.12.2019, pika 2.4, germa a, për miratimin e rregullores “Për Organizimin të Drejtat, Detyrat dhe Funksionimin e Komisioneve Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar.

Nga verifikimet automatike në sistem me ISSH, për njësitë administrative që marrin shërbime në Poliklinikën e Specialiteteve Nr.1 Tiranë rezultoi se kanë përgjigje në sistem për 7 përfitues. Nga kontrolli i këtyre dosjeve rezultoi se në këto dosje ndodheshin dokumente zyrtare nga ISSH dhe komisioni i vlerësimit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar dhe vepruar komform ligjit Nr.57, datë 18.07.2019 “Për Asistencën Sociale në Republikën e Shqipërisë”.

Nga verifikimet automatike në sistem me DPT, për njësitë administrative që marrin shërbime rezultoi se ka përgjigje në sistem për 65 përfitues. Pas verifikimeve në Regjistrin Elektronik Kombëtar u konstatua se për 55 individë që rezultojnë me përgjigje (kontribute) janë përfitues sipas skemës së vjetër të aftësisë së kufizuar dhe në bazë të ligjit nr 57/2019 nuk trajtohet si shkelje. 5 persona kanë në dosjet e tyre dokumente zyrtare nga DPT janë s’kualifikuar pasi konsiderohet shkelje dhe janë orientuar te skema e ISSH-së. Ndërsa 5 persona janë kualifikuar pasi nuk përfitojnë në bazë të ligjit nr. 7703 “Për Sigurimet Shoqërore” i ndryshuar (nuk plotësojnë kriterin ligjor 12 muaj kontribute në 5 vitet e fundit). Nga verifikimi elektronik i informacionit në Regjistrin Elektronik Kombëtar për muajin dhjetor 2020 mbi respektimin e afateve të kontrollit mjekësor vjetor (dorëzimi i formularit nr.8) nuk kanë dorëzuar formularin e kontrollit vjetor mjekësor 11 aplikantë kjo në kundërshtim me VKM Nr. 722, datë 11.11.2019, kreu III, pika 4, çështja g .

Mjeku specialist dhe mjeku i familjes duhet të përcaktoje diagnozën dhe nivelin e vështirësisë sipas udhëzuesit bio- psiko-social të mbështetur në dokumentacionin mjekësor dhe ekzaminimet mjekësore përkatëse kjo e dokumentuar në kartelën mjekësore. Nga kontrolli i 49 rasteve rezultoi se mungoni kartetat për 17 raste.

Nga kontrolli i ushtruar në këto 4 Komisione Vlerësimi janë konstatuar problematika si dhe janë lënë rekomandime dhe detyra si më poshtë:

- Nga kontrolli me përzgjedhje rastësore i 143 dosjeve fizike (107 përfitues nga skema e vjetër dhe 36 për herë të parë) të personave me aftësi të kufizuar pranë Komisioneve Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar pranë Drejtorisë Rajonale Tiranë u konstatua se në zbatim të VKM Nr. 722, datë 11.11.2019, pika 2, 3 në shumicën e dosjeve ndodhet karta e identitetit (certifikata personale), formulari i aplikimit, mjekut të familjes, mjekut specialist dhe formulari i vlerësimit si dhe dokumentacioni mjekësor i kërkuar sipas Udhëzuesit për Vlerësimin Bio-Psikosocial.
- Në disa prej dosjeve mungon një pjesë e dokumentacionit mjekësor të kërkuar sipas Udhëzuesit për Vlerësimin Bio-Psikosocial. Kjo në kundërshtim me Urdhërin nr. 225, datë 06.12.2019, pika 2.4, germa a, për miratimin e rregullores “Për Organizimin të Drejtat, Detyrat dhe Funkcionimin e Komisioneve Shumëdisiplinore të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar, ku Mjeku i KSHVAK ka për detyrë të sigurojë që i tërë informacioni mjekësor plotëson standardet për vlerësimin dhe përcaktimin e aftësisë së kufizuar dhe nivelin e dëmtimit në përputhje me kriteret e udhëzuesëve Bio-Psiko-Socialë të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar.

Grupi i kontrollit ka lënë detyrë që të vijohet me zbatimin e detyrave mbi plotësimin e dokumentacionit për përfitimin e aftësisë së kufizuar si dhe ekzaminimet mjekësore përkatëse sipas diagnozave të përcaktuara në Udhëzuesin e Vlerësimit Bio-Psiko-Social për të rritur dhe fëmije.

- Nga verifikimi elektronik i informacionit në Regjistrin Elektronik Kombëtar në zbatim të VKM Nr. 722, datë 11.11.2019, kreu III, pika 4, germa c në lidhje me ISSH dhe DPT konstatohet se me Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe me Drejtorinë e përgjithshme të tatimeve rezulton se ka përgjigje në sistem.

Pas verifikimeve në Regjistrin Elektronik Kombëtar u konstatua se pjesa më e madhe e individëve që rezultojnë me përgjigje (kontribute) janë përfitues sipas skemës së vjetër të aftësisë së kufizuar dhe në bazë të ligjit nr 57/2019 nuk trajtohet si shkelje.

Personat që kanë në dosjet e tyre dokumente zyrtare nga DPT të dala nga sistemi janë s’kualifikuar pasi konsiderohet shkelje dhe janë orientuar te skema e ISSH-së, ndërsa personat e tjerë janë kualifikuar pasi nuk përfitojnë në bazë të ligjit 7703 “Për Sigurimet shoqërore” i ndryshuar (nuk plotësojnë kriterin ligjor 12 muaj kontribute në 5 vitet e fundit), kjo e shoqëruar me shkresë zyrtare nga ISSH.

- Nga verifikimi elektronik i informacionit në Regjistrin Elektronik Kombëtar për muajin dhjetor 2020 e në vazhdim, mbi respektimin e afateve të kontrollit mjekësor vjetor (dorëzimi i formularit nr. 8) nuk kanë dorëzuar formularin e kontrollit vjetor mjekësor pranë Komisionit Shumëdisiplinor të Vlerësimit të Drejtorisë Rajonale

Tiranë 42 aplikantë, kjo në kundërshtim me VKM Nr. 722, datë 11.11.2019, kreu III, pika 4, çështja g.

Grupi i kontrollit ka njoftuar Drejtorinë Rajonale Tirane në lidhje me respektimin e afateve ligjore mbi dorëzimin e formularit të kontrollit vjetor mjekësor (dorëzimi i formularit nr.8) pranë Komisionit Shumë disiplinor të Vlerësimit të Aftësisë së Kufizuar.

- ***Nga kontrolli na rezulton se ka ndryshime të përcaktimit të nivelit të dëmtimit nga vlerësimi i mjekut specialist dhe komisionit shumëdisiplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar, në të shumtën e rasteve niveli i dëmtimit i përcaktuar nga komisionit shumëdisiplinor i vlerësimit të aftësisë së kufizuar është më i ulët se niveli i dëmtimit të përcaktuar nga mjeku specialist.***
- Mjeku specialist dhe mjeku i familjes duhet të përcaktoje diagnozën dhe nivelin e vështirësisë sipas udhëzuesit bio- psiko-social të mbështetur në dokumentacionin mjekësor dhe ekzaminimet mjekësore perkatatëse kjo e dokumentuar në kartelën mjekësore. Nga kontrolli i 143 rasteve rezultoi se mungoni kartetat për 19 raste.

Grupi i kontrollit ka njoftuar Operatorin e Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor në lidhje me detyrimet që kanë Mjekët specialist dhe Mjekët e familjes pasi duhet të përcaktojnë diagnozën kryesore të pacientit sipas emërimit në Udhëzuesin e Vlerësimit Bio-Psiko-Social për të rritur dhe fëmije dhe ta mbështesi këtë diagnozë mbi të gjitha ekzaminimet dhe dokumentacionin mjekësor të përcaktuar në udhëzues, e dokumentuar në kartelën shëndetësore.

II. DREJTORIA E KOMISIONIMIT TË PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Në këtë fushë të mbrojtjes sociale konsiderojmë arritje për periudhën Janar –Dhjetor 2021:

1. Uljen e numrit të personave me aftësi të kufizuar me 2354 persona.

Sot përfitojnë Pagesë për Aftësinë e Kufizuar mesatarisht per periudhën janar-dhjetor 2021, 71364 persona, 2354 persona më pak krahasuar me vitin 2020 ku ishin 73718 persona.

Faktorët që kanë ndikuar në uljen e numrit të personave përfitues të AK janë:

- Ngritja e 4 komisioneve të Nivelit të Parë në Tiranë për vlerësimin e dosjeve në nivelin Qendor dhe jo më në nivel Rajonal (nga 11 komisione në 4 të tilla).
 - Shmangie të konfliktit të interesit dhe një vlerësim më të specializuar të dosjeve.
 - Vlerësimi i dosjeve bëhet më i drejtë pasi komisionet janë të ndara sipas specialiteteve.
2. Komisionet që funksionojnë pranë SHSSH kanë realizuar me sukses aktivitetin e tyre në komisionimin e PAK duke konsideruar faktorët kufizues:
 - Periudha e karantinimit gjatë pandemisë së Covid-19 ka sjell grumbullim të dosjeve.
 - Mungesa e mjekëve anëtarë të komisionit si pasojë e infektimit me Covid-19.
 - Numri i personave të planifikuar për komision, për shkak të masave për parandalimin e covid-19, ka qënë i reduktuar në krahasim me komisionimet në kushte normale.
 3. Ngritja e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave në nivel qëndror për modelin bio-psiko-social, i cili ka realizuar plotësisht objektivin e tij për komisionimin brenda afateve të dosjeve. Me gjithë vështirësitë që ka pasur si komision i ri dhe dosje të grumbulluara ka arritur të komisionojë 1077 dosje aq sa janë protokolluar pranë Drejtorisë së Përgjithshme nga DRSHSSH Tiranë.
 4. Shtrirja e reformës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar sipas modelit bio-psiko-social në Durrës, Elbasan dhe Korçë.

OBJEKTIVI I

REZULTATET E KOMISIONIMEVE TË PAK

Objektivi kryesor i përfaqësuesve të SHSSH në komisionime është respektim i legjislacionit dhe kriterëve mjekësore gjatë procesit të administrimit dhe komisionimit të PAK. Aktiviteti kryesor i kësaj drejtorie është ndjekja e ecurisë së komisionimeve të PAK në KMCAP-et e Nivelit të Parë, komisionimi në KMCAP Epror i personave që ankimojnë vendimet e KMCAP-eve të Nivelit të Parë, si dhe komisionimi sipas modelit Bio-Psiko-Social.

1. KMCAP-et EPROR

Gjatë vitit 2021 janë komisionuar dhe vlerësuar në KMCAP Epror 5800 qytetarë, prej të cilëve janë larguar nga skema e PAK 1641 individë (pa grup), ndërsa 4159 individë vijojnë përfitimin nga skema e PAK. Gjatë vitit 2021 është ngritur për herë parë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave për modelin bio-psiko-social, i cili shqyrton të gjitha ankesat e personave që ankimojnë vendimin e komisionit shumëdisiplinor të vlerësimit të aftësisë së kufizuar në nivel rajonal.

| KMCAP-EPROR | Komisionuar | Përfitues | Jo përfitues |
|-----------------------------------|--------------------|------------------|---------------------|
| Neurologji/Paratetraplegji | 2190 | 1464 | 726 |
| Shëndet Mendor | 601 | 428 | 173 |
| Sëmundjet e Përgjithshme | 1230 | 865 | 365 |
| Verbëri | 702 | 624 | 78 |
| Komision i Shqyrtimit të Ankesave | 1077 | 778 | 299 |
| Total | 5800 | 4159 | 1641 |

2. KMCAP-et e NIVELIT TË PARË

Drejtorja e Komisionit të PAK ndjek në vijimësi dinamikën e vlerësimeve të bëra në KMCAP-et e nivelit të parë, në mënyrë që të analizojë riskun dhe të alertojë mjekët e komisioneve të nivelit të parë kur vërehet rritje e pajustificuar e skemës.

2.1. Në KMCAP- niveli i parë janë regjistruar 27000 dosje të ardhura nga DRSHSSH Rajonale për komisionim, janë komisionuar gjithsej 32911 dosje nga të cilët janë vlerësuar 25636 përfitues dhe 7275 jo përfitues.

| KMCAP-NIVEL I PARË | Komisionuar | Përfitues | Jo përfitues |
|--|--------------------|------------------|---------------------|
| Neurologji/Patratetraplegji | 10375 | 7292 | 3083 |
| Sëmundjet Interne | 6930 | 4893 | 2037 |
| Shëndet Mendor | 9412 | 8800 | 612 |
| Onkologji,Ortopedi,Kirurgji,Reumatologji | 6194 | 4651 | 1543 |
| Total | 32911 | 25636 | 7275 |

2.2. Komisionet shumëdisiplinore bio-psiko-sociale

Reforma e vlerësimit të Aftësi së Kufizuar sipas modelit bio-psiko-social gjatë vitit 2021 është zbatuar në Rajonin e Tiranës, Durrësit, Elbasanit. Janë komisionuar 6819 persona, nga të cilët 6278 janë përfitues dhe 541 individë jo përfitues.

| Komisioni shumë disiplinor bio-psiko-social | Komisionuar | Përfitues | Jo përfitues |
|--|--------------------|------------------|---------------------|
| Tiranë | 5750 | 5250 | 500 |
| Durrës | 608 | 578 | 30 |
| Elbasan | 461 | 450 | 11 |
| Total | 6819 | 6278 | 541 |

| Komisionime për herë të parë | Aplikues | Përfitues | Jo përfitues |
|-------------------------------------|-----------------|------------------|---------------------|
| Tiranë | 1233 | 950 | 283 |
| Durrës | 196 | 182 | 14 |
| Elbasan | 83 | 72 | 11 |
| Total | 1512 | 1204 | 308 |

2.3 KMPV

Në KMPV gjatë vitit 2021 janë regjistruar 3346 dosje të ardhura nga Njësitë Administrative, janë komisionuar 4647 dosje, nga të cilët 3622 janë përfitues dhe 1025 individë jopërfitues.

OBJEKTIVI II

SHTRIRJA E REFORMËS SË VLERËSIMIT TË AFTËSISË SË KUFIZUAR SIPAS MODELIT BIO-PSIKO-SOCIAL

1. Reforma e vlerësimit të aftësisë së kufizuar sipas modelit bio-psiko-social është reflektimi i praktikës bashkëkohore ndërkombëtare të shndërrimit të vlerësimit mjekësor në vlerësim bio-psiko-social, për të reflektuar konceptin e ri të aftësisë së kufizuar si një ndërveprim të dëmtimeve funksionale të shkaktuara nga një sëmundje me faktorë psikologjikë e socialë.
2. Zyrat e vlerësimit janë të pajtura me kamera, që reduktojnë ndjeshëm shkallën e abuzimit, rrisin besueshmërinë dhe përmirësimi i shërbimit për qytetarët.
3. Për më tepër, ky reformim është një domosdoshmëri për të unifikuar qasjen e vlerësimit me parimet e shprehura në Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara, si dhe me nenin përkatës të ligjit nr. 93/2014, datë 24.7.2014 ‘Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara (kapitulli III, neni 10).

Gjatë vitit 2021 kanë vijuar përgatitjet për shtrirjen e modelit bio-psiko-social në Qarkun Elbasan, Durrës, Korçë, Lezhë, Shkodër dhe Vlorë.

1. Në Qarkun e Durrësit janë ngritur 3 zyra vlerësimi, të cilat kanë filluar të funksionojnë dhe nuk ka probleme.

2. Në Qarkun e Elbasanit janë ngritur 6 zyra vlerësimi, të cilat po vazhdojnë aktivitetin edhe pse ka disa problematika si mungesa e stafit dhe infrastruktura.

3. Në Qarkun e Korçës janë ngritur 3 zyra vlerësimi, të cilat nuk kanë filluar të funksionojnë për shkak të mungesë së stafit (mjekë), dhe disa ndryshimeve që duheshin në infrastrukturë që ambientet të ishin të aksesueshme nga personat me Aftësi të Kufizuar.

Për tre Qarqet e mësipërme janë bërë:

- Trajnimi i mjekëve të familjes dhe mjekëve specialistë nga SHSSH dhe MSHMS;
 - Përgatitja e hartave dhe shpërndarja sipas njësive administrative, sipas komisioneve.
 - Fushata e Komunikimit për sensibilizimin dhe njohjen me modelin bio-psiko-social të vlerësimit të personave me aftësi të kufizuar para shtrirjes së këtij modeli, u organizua nga MSHMS dhe SHSSH. Gjatë takimeve u prezantua procedura e vlerësimit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar, legjislacioni, roli i secilit në këtë model vlerësimi.
4. Në Qarqet Lezhë, Shkodër, Vlorë është bërë përcaktimi i ambienteve ku do të zhvillojnë aktivitetin komisionet shumë disiplinore të vlerësimit të AK dhe po vazhdohet me përgatitjen nga ana e infrastrukturës. Janë shpallur vendet vakante për stafin.

III. SEKTORI I AUDITIT TË BRENDSHËM

Veprimtarisa e Auditimit të Brendshëm bazohet në ligjin nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Manualin e Auditimit të Brendshëm miratuar me Urdhër 100, datë 25.10.2016, i ndryshuar, standardet ndërkombëtare të auditimit të brendshëm dhe akte të tjera në fushën e auditimit të brendshëm.

REZULTATET E VEPRIMTARISË SË AB

Plani gjatë vitit 2021 është rishikuar për shkak të:

- Mungesës së 1 audituesi gjatë gjithë vitit;
- Kërkesës së titullarit për kryerje auditimi në 1 subjekt të paplanifikuar (SHM Fier);
- Masave të marra në kuadër të parandalimit të përhapjes së pandemisë COVID-19 (QZH Durrës).

Në bazë të planit të rishikuar në vitin 2021 janë planifikuar 7 auditime. të cilat janë realizuar në masën 100%, nga ku 6 dosje auditimi janë evaduar dhe me kthim përgjigje nga subjekti për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve, ndërsa 1 dosje auditimi ndodhet në procesin e raportimit të zbatimit të rekomandimeve (Shtëpia e Foshnjës Vlorë).

FUSHAT ME RISK DHE TRAJTIMI I TYRE

Në planifikim dhe angazhimet e ushtruara në subjektet e audituara janë përcaktuar edhe risqet kryesore të identifikuar dhe trajtuara në raportet e auditimit për të cilat janë lënë rekomandimet përkatëse për menaxhimin e riskut dhe përmirësimin e veprimtarisë.

a) **Sistemi i pagave, shpërblime dhe trajtime**, është konsideruar me *nivel të lartë* risku nga auditimi 2021:

- Të ndodhur para një situatë jo të zakonshme për shkak të pandemisë COVID 19, ku në kuadër të masave të marra për parandalimin e përhapjes së saj, punonjëset e IPSH-ve janë karantinuar në mars-maj 2020, shtesa e pagës për orët jashtë kohës normale të punës nuk është në përputhje me Kodin e Punës me ndryshime dhe aktet në zbatim të tij, duke tejkaluar pagesën e 200 orëve në vit dhe shkaktuar dëm ekonomik të kthyeshëm nga përfituesit.
- Mangësi në përloqaritjen e pagës për periudhën e paaftësisë së përkohshme në punë.
- Paga jo në përputhje me pozicionin në bazë të emërimit.
- Mangësi në zbatimin e VKM. 977/2010 “ Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim brenda vendit”, i ndryshuar.

Mangësitë e mësipërme sjellin efekte financiare.

b) **Në sistemin e administrimit të aktiveve** është konstatuar një *nivel i lartë* risku:

- Mangësi në evidentimin e menjëhershëm të hyrjes e daljes së aktiveve në magazinë.
- Mosregjistrim në kohë të lëvizjes së aktiveve në magazine në librin e magazinës/kartelat e aktiveve
- Mangësi në plotësimin e fletë hyrjeve e fletë daljeve dhe mungesë kontrolli.

- Mangësi në plotësimin e regjistrimit të aktiveve në zbatim të Udhëzimit 30/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.
- Mangësi në procedurat e inventarizimit, në ngritjen e komisioneve dhe procedurat për nxjerrjen jashtë përdorimi.
- Mangësi në hartimin e inventarëve sipas personave që i kanë në përgjegjësi.

c) **Në fushën e programimit dhe zbatimit të buxhetit** konsiderohet si sistem me *risk të mesëm* ku nga auditimet e kryera janë konstatuar mangësi në zbatimin e ligjit 10296, datë 8.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet në zbatim të tyre.

- Programimi i fondeve për mallra e shërbime pa vlerësimin e indikatorëve dhe normave të shpenzimeve, nevojave dhe sasitë përfundimtare të produkteve dhe shërbimeve që do të kryhen, duke mos argumentuar kostot e programimit për shpenzime operative e shpenzime investimi, (sasi e çmim).
- Mangësi në regjistrimin e shpenzimeve sipas nomenklaturës së shpenzimeve dhe plotësimin e formatit standard “Situacioni i shpenzimeve”.
- Ka raste që pagesa e faturave të kontraktorëve të furnizimit me energji dhe ujë është jashtë afatit kohor prej 30 ditë të përcaktuar në aktet rregullatore, e cila sjell rritje të shpenzimeve financiare për shkak të penalteteve të ndryshme.
- Ka raste të pagesës së furnizimit me mallra e shërbime pa i marrë në dorëzim sipas specifikimeve të kërkuara.

d) **Në Sistemin e Prokurimeve** është konstatuar *nivel i mesëm* risku për shkak se ka mangësi në zbatimin e akteve rregullatore të fushës së prokurimeve:

- Hartimi i regjistrimit të parashikimit dhe realizimit të prokurimeve publike, ka ardhur në përparim për shkak dhe të ndryshimeve në aktet rregullatore.
- Ka raste që Urdhërat e prokurimit dalin pa specifikuar mallin/shërbimin/punën që do të prokurimet në sasi e njësi, sipas formularit standard të blerjes me vlerë të vogël.
- Mungesë të administrimit të përlllogaritjes së fondit limit.
- Kalimi nga ofertuesi i parë deri të ofertuesi i shpallur fitues nuk është dokumentuar sipas udhëzimeve për prokurimin blerje me vlerë të vogël.
- Mungesë e deklaratës së konfliktit të interesit.
- Mungesë e raportit përmbledhës të realizimit të kontratës.
- Ka raste të pagesës së operatorit ekonomik pa marrë në dorëzim mallrat apo shërbimin sipas specifikimeve të kërkuara.
- Mosarkivimi i dosjes së prokurimit sipas ligjit “Për arkivën”.

e) **Sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar**

- Nga auditimi i subjekteve janë konstatuar parregullësi në mbajtjen e evidencës kontabile, si ditari i shpenzimeve në regjistrimin e transaksioneve në nivel 7 shifror, ditari i të ardhurave, ditari i veprimeve me magazinën.
- Mosevidentim sipas rregullave të veprimeve të mbylljes së llogarisë vjetore.
- Mosevidentim i detyrimeve sipas rregullave kontabël.

f) Sistemi i kontrollit të brendshëm

- Drejtuesit e njësisë kanë përgjegjësinë e krijimit të sistemit të kontrollit të brendshëm (MFKB) në njësinë e tyre.
- Mangësitë e konstatuara në sistemet e veprimtarisë tregojnë dobësi në funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm.

Vetë struktura e institucioneve të përkujdesit social e cila përbëhet nga 1 financier i cili është dhe nëpunës zbatues njëkohësisht nuk është në përputhje me ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin neni 22, pika 3, shkronja b e cila përcakton ndarjen e detyrave në fushën e dhënies së autorizimit në atë formë, në mënyrë që i njëjti punonjës të mos jetë përgjegjës në të njëjtën kohë për propozimin, miratimin, zbatimin, kontabilitetin dhe kontrollin.

Menaxhimi i riskut vazhdon të jetë sfidë për institucionet. Njësitë në përgjithësi kanë hartuar regjistrin e riskut, por ka mangësi në përcaktimin e riskut që ndikon në realizimin e objektivave, përcaktimin e kontroleve për parandalimin e riskut dhe evidentimin e tyre.

REKOMANDIMET

Nga ana e auditëve për çdo gjetje të konstatuar dhe trajtuar është lënë rekomandimi përkatës për përmirësimin e fushës në të ardhmen dhe menaxhimin e riskut.

Nga institucionet ka pasur reagime pozitive duke pranuar 100 % rekomandimet e adresuara. Është përgjegjësi e titullarit të subjektit të audituar kthimi i përgjigjes brenda afatit 30 ditor, për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të lëna në Raportin Përfundimtar. Ky afat është respektuar në përgjithësi nga subjektet.

Pas kthimit të përgjigjes nga subjekti për masat e marra për zbatimin e rekomandimeve është hartuar Memo për titullarin e Drejtorisë së Përgjithshme të SHSSH dhe për Kryetarin e Bashkisë për institucionet në varësi strukturore të pushtetit vendor.

Për 7 auditimet e kryera për të cilat është dërguar Raporti Përfundimtar, janë lënë gjithsej 51 rekomandime, afërsisht 7 rekomandime për subjekt.

Në tabelën më poshtë jepen subjektet e audituara dhe progresi i rekomandimeve të adresuara nga auditimi në bazë të raportimit të subjekteve.

| | Subjektet e audituara që kanë dërguar Plan veprimin e rekomandimeve | Numri i Rekomandimeve | Niveli i zbatimit | | |
|---|---|-----------------------|-------------------|-----------|--------|
| | | | Pranuar | Realizuar | Proces |
| 1 | Zbatimi i rekomandimeve të adresuara në vitin 2020 | 3 | 3 | 3 | |

| | | | | | |
|---|---|-----------|-----------|---------------|---------------|
| 2 | Shtëpia e Foshnjës Sauk | 13 | 13 | 11 | 2 |
| 3 | Shtëpia e Fëmijëve “Zyber Hallulli” | 12 | 12 | 11 | 1 |
| 4 | DFS “Bonusi i bebes” | 1 | 1 | 1 | |
| 5 | DR SHSSH Durrës | 7 | 7 | 5 | 2 |
| 6 | Shtëpia e të Moshuarve Fier | 4 | 4 | 2 | 2 |
| | Rekomandime | 40 | 40 | 33 | 7 |
| | Realizimi në % | | | 82.5 % | 17.5 % |
| | Subjekti audituar në procesin e raportimit të rekomandimeve të adresuara | | | | |
| 7 | Shtëpia e Foshnjës Vlorë | 11 | 11 | | 11 |
| | Gjithsej rekomandime | 51 | 51 | 33 | 18 |

Sa më sipër niveli i zbatimit të rekomandimeve sipas raportimit të 6 subjekteve (sepse 1 subjekt është në procesin e raportimit brenda afatit 30 ditësh nga marrja e raportit përfundimtar), është në masën rreth 82.5%.

Rekomandimet që sipas raportimit nga subjektet janë në proces janë kryesisht rekomandimet

- Në sistemin e menaxhimit të aktiveve, subjektet janë në procesin e inventarizimit.
- Në sistemin e kontabilitetit, subjektet janë në periudhën e hartimit të mbylljes së llogarisë vjetore.
- Ndalesat për pagesa të marra jo në përputhje me aktet ligjore, janë në proces të mbajtjes së tyre.
- Hartimi i projekt buxhetit është në periudhën Korrik.

SIGURIMI I BRENDSHËM I CILËSISË SË VEPRIMTARISË AUDITUESE

Rishikimi i cilësisë është kryer hap pas hapi deri në evadimin e dosjes për të krijuar një siguri të arsyeshme se po veprohet në përputhje me standardet, praktikat profesionale të auditimit të brendshëm dhe të kartës së auditimit. Referuar procedurave të përcaktuara në Manualin e Auditimit të Brendshëm sqarojmë se monitorimi dhe sigurimi i brendshëm i cilësisë për veprimtarinë audituese është realizuar gjatë gjithë procesit të auditimit nga audituesi, përgjegjësi i grupit dhe Përgjegjësi i Sektorit të Auditimit.

Vlerësimi i brendshëm i cilësisë është kryer në bazë të Programit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, ku janë përcaktuar dhe indikatorët e matjes së performancës për rishikimin e

auditimeve të kryera, me qëllim që të sigurohet vlerësimi i veprimtarisë audituese në përputhje me standardet ndërkombëtare të pranuar.

Janë plotësuar anekset përkatëse sipas kritereve të vendosura nga auditët, përgjegjësi i grupit dhe përgjegjësi i sektorit. Gjatë rishikimit të cilësisë janë lënë rekomandime në drejtim të rritjes së cilësisë, vendosjes drejt të referencave ligjore, të trajtimit të gjetjes mbështetur te Udhëzimi i MFE, të cilat janë marrë parasysh dhe reflektuar.

PRIORITETET PËR VITIN 2022

Për rritjen e efektivitetit të veprimtarisë së auditimit të brendshëm për vitin 2022 kemi si prioritet:

- Garantimin e zhvillimit të veprimtarisë audituese në përputhje me praktikat më të mira profesionale e standardeve të auditimit të brendshëm.
- Realizimin e veprimtarisë audituese të orientuar në vlerësimin e riskut sipas sistemeve/fushave.
- Bashkëpunimi me titullarët e subjekteve të audituara për reagimin dhe marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve të adresuara dhe raportimin për ecurinë e tyre në vazhdimësi.

IV. DREJTORIA E FINANCËS DHE STATISTIKËS


Drejtoria e Financave dhe Statistikës në Shërbimin Social Shtetëror ka për mision zbatimin e politikave, legjislacionit të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimet shoqërore për:

- 30 Institucione të Përkujdesit Shoqëror;
- 12 Zyra Rajonale;
- Agjencinë Shtetërore të Mbrojtjes së Fëmijëve;
- Administratën Qendrore të Shërbimit Social Shtetëror;
- 61 Njësi Administrative.

Gjatë vitit 2021 nga ana e DFS janë vendosur disa objektiva të cilat bëjnë të mundur mbarëvajtjen e punës dhe realizimin në kohë dhe me cilësi të detyrave. Koncretisht:

- Mirë-menaxhimi i fondeve buxhetore;
- Mirë-menaxhimi i aseteve;
- Bonusi i bebes;
- Transparencë e plotë e shpenzimeve;
- Korrupsion zero;
- Zbutja dhe lehtësimi i varfërisë;
- Zhvillimi i shërbimeve të kujdesit shoqëror.

Më poshtë numri i familjeve në skemën e NE gjatë 2021 për secilin qark i krahasuar me 2020




Grafik: Krahasimi i numrit të familjeve në skemën e NE sipas Qarqeve.

Në rastin e pagesave për përfituesit në skemën e Ndhmës Ekonomike, më poshtë paraqitet numri i familjeve, pjesë e skemës së NE dhe situata e fondeve për vitet 2020-2021 duke përfshirë të gjithë komponentët e kësaj skeme (familje në NE dhe individë).

Tregues: Numri mesatar i familjeve pjesë e skemës së Ndhmës Ekonomike për vitet 2020-2021 (pa përfshirë individët dhe 6%)


- Për vitin 2020 61,640 Familje
- Për vitin 2021 67,175 Familje



Siç shihet nga grafiku nëse krahasohet numri i familjeve në skemë nga viti 2020 në 2021, kemi një rritje me 1074 familje ose 2%.

Tregues: Fondi i shpenzuar për familjet pjesë e skemës së Ndhmës Ekonomike për vitet 2020-2021 (pa përfshirë individët dhe 6%). Në fondin e të dy viteve përfshihet shtesa për pandeminë covid-19.

- Për vitin 2020 4,338,172,552 lekë
- Për vitin 2021 4,989,810,570 lekë




Grafik: Fondi i shpenzuar për familjet pjesë e skemës së NE

Duke analizuar shifrat e paraqitura më sipër, vihet re se fondet e shpenzuara për familjet në skemën NE, në vitin 2021 referuar periudhës janar-tetor janë më të larta se e njëjta periudhë e vitit 2020. Kjo si rrjedhojë e shtesës së dhënë gjatë pandemisë covid-19 dhe gjithashtu rritjes me 2% e nr. të familjeve përfituese të skemës së NE. Përgjatë vitit 2020 shtesa covid-19 është aplikuar për periudhën 4-mujore mars-qershor, kurse për vitin 2021 shtesa e fondit për covid-19 është aplikuar për periudhën 6 mujore janar-qershor. Kjo situatë reflektoi rritjen me 13 % të fondit të shpenzuar për familjet e skemës së NE përgjate vitit 2021 krahasuar me vitin e më mëparshëm.

Tregues: Numri mesatar i individëve pjesë e skemës së PAK për vitet 2020-2021 (pa përfshirë kujdestar dhe invalid)

- Për vitin 2020 73.718 persona me AK
- Për vitin 2021 71.364 persona me AK




Grafik: Numri mesatar i përfituesve në skemën e PAK

Nga viti 2020 në vitin 2021, numri i individëve që përfshihen në pagesën e PAK, është ulur me 2.354 persona.


Tregues: Fondet e shpenzuara për skemën e PAK

- Për vitin 2020 12,984,118,655 lekë
- Për vitin 2021 11,685,245,457 lekë



Grafik: Fondet e shpenzuara për individët në skemën e PAK

Më poshtë numri i personave me aftësi të kufizuar gjatë 2021 për secilin qark i krahasuar me vitin 2020.




Grafik: Krahasimi i numrit të personave me aftësi të kufizuar sipas Qarqeve.

Të dhënat për skemën e PAK janë deri në muajin tetor 2021(të dhënat për muajt nëntor- dhjetor përpunohen në 30 janar).

Më sipër paraqitet shpenzimi fondeve vetëm për personat me PAK dhe ky fond për vitin 2021 është ulur me 1.298.873.198 lekë në krahasim me vitin 2020.

Invalidët e punës

- Për vitin 2020 74.734 invalidë pune
- Për vitin 2021 73.352 invalidë pune



Grafik: Numri mesatar i invalidëve të punës


Numri i invalidëve të punës në vitin 2021 është ulur me 1.382 persona, në krahasim me vitin 2020.

Shënim: Analiza vjetore 2021 për statistikën zyrtare të familjeve në skemën e Ndihmës Ekonomike dhe PAK bazohet në periudhën krahasimore janar-tetor 2020 dhe janar-tetor 2021, pasi përpunimi i statistikave për dymujorin nëntor-dhjetor 2021 përfundojnë në 31.01.2022. Në analizë përfshihet edhe fondi i shtuar për periudhën e pandemisë covid-19 . Shtesa covid-19 bazohet në legjislacionin më poshtë: Vendim nr.85, datë 10.02.2021”Për një shtesë në vendimin nr.597, datë 4.9.2019 të Këshillit të Ministrave”, ”Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të Ndihmës Ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndihmën Ekonomike”

Realizimi sipas zërave të buxhetit paraqitet si më poshtë:

Tregues: Financimet në lekë nga Buxheti i Shtetit/Kontributet me fonde të buxhetit të shtetit për të gjitha llogaritë në vite:


- 2020 27.976.830.300 lekë
- 2021 27.889.091.037 lekë



Grafik: Akordimi i fondeve në total për të gjitha llogaritë për vitet 2020-2021

Tregues: Ecuria e fondeve duke përfshirë të gjithë komponentët e skemës së NE llogaria 606

- Për vitin 2020 5,434,643,565 lekë ose 99.65%
- Për vitin 2021 5,972,865,161 lekë ose 98%




Grafik: Realizimi i fondeve për llogarinë 606 NE

Siç theksuam më lart, fondet e NE me të gjithë komponentët kanë pësuar rritje pasi për periudhën Janar - Qershor është dyfishuar NE si pasojë e pandemisë, për të zbutur varfërinë.

Tregues: Ecuria e fondeve duke përfshirë të gjithë komponentët e skemës së PAK llogaria 606

- Për vitin 2020 18.465.130.056 lekë ose 99%
- Për vitin 2021 16,456,813,684 lekë ose 98.89%




Grafik: Realizimi i fondeve për llogarinë 606 PAK

Realizimi sipas zërave të buxhetit paraqitet si më poshtë:

A. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 600 paga është:

- 2020 492.802.953 lekë ose 99.64 %
- 2021 477.853.070 lekë ose 91.94 %




Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 600 për vitet 2020-2021

Realizimi i fondeve për llogarinë 600 është në masën 91.94 %, ky koeficient i lartë tregon mirëmenaxhimin të kësaj llogarie.

B. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 601 Sigurime Shoqërore është:

- 2020 80859.693 lekë ose 85.75 %
- 2021 78.817.457 lekë ose 82.10 %




Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 601 për vitet 2020-2021

Realizimi i fondeve për llogarinë 601 është në masën 82.10 %, shkon në proporcion me realizimin e plotë të fondit të pagave.

C. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 602 shpenzime operative është:

- 2020 301.159.162 lekë ose 95.97%
- 2021 313.642.797 lekë ose 97.41 %




Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 602 për vitet 2020-2021

Realizimi i fondeve për llogarinë 602 është në masën 97.41 %, ky koeficient i lartë tregon mirëmenaxhimin të kësaj llogarie.

D. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 606 Fond për financimin e Shërbimeve të përkujdesit në Bashki e Qarqe është:

- 2020 94.481.128 lekë ose 69%
- 2021 145.188.353 lekë ose 78.83 %




Grafik: Ecuria e fondeve për financimin e shërb.përk. në Bashki dhe Qarqe

Realizimi për këtë tregues është 78.83%, krahasuar me 2020 që ishte 69%, pasi edhe nga Qarqet/Bashkitë të cilave fondi u është akorduar gjatë muajve të parë 2021 nuk i kanë mirëmenaxhuar fondet duke mos përdorur një fond prej 38.972.123 lekësh, gjithashtu dhe bashkive të cilat iu financuan shërbimet gjatë viti 2021 nuk i kanë mirëmenaxhuar fondet.

E. Realizimi i fondeve të shpenzuara për llogarinë 231 Investime është:

- 2020 5.339.286 lekë ose 68 %
- 2021 2.419.524 lekë ose 84.89 %



Grafik: Akordimi i fondeve për llogaritë 231 për vitet 2020-2021

Gjatë vitit 2021 SHSSH i është akorduar fond investimesh me destinacion "Rehabilitim i zyrave të Drejtorisë Rajonale Durrës". Nisur nga sa më sipër realizimi i kësaj llogarie është në masën 84.89%.

Prej gushtit 2021 SHSSH ju ka ngarkuar drejtorive rajonale shpërndarjen e çeqeve për bebet që lindin jashtë vendit dhe ato që lindin në spitalet private të vendit. Për periudhën Janar - Dhjetor 2021 SHSSH dhe Drejtoritë Rajonale kanë shpërndarë rreth 19.164 çeqe dhe kanë realizuar një fond prej 3.256.778.000 lekësh.

***Shënim:** Analiza vjetore 2021 për realizimin e buxhetit të dhënat janë paraprake pasi veprimet në Drejtorinë e Thesarit, do vazhdojnë deri në datë 26 Janar 2022, për llogari të vitit 2021.*

PROBLEMATIKAT

Ndërkohë gjatë vitit 2021 krahasuar me vitit 2020 problematikat kanë qenë të shumta, më poshtë disa prej tyre:

- Diferenca e madhe ndërmjet kërkesës së paraqitur në Projekt Buxhetin 2020-2022, kërkesës në fund të vitit 2020 dhe akordimit të fondeve për vitin 2021.
- Akordimi i fondeve vetëm gjatë muajve të fundit solli mos kryerje të disa prokurimeve për mbarëvajtjen e punës në IPSH dhe DR në varësi të DPSHSSH shtesë (pas dhjetra kërkesave zyrtare për shtesë fondesh duke filluar nga janari 2021).
- Akordimi i fondeve kundrejt bashkive ose qarqeve gjatë vitit, për financimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror dhe mospërdorimi i plotë nga ana e tyre.
- Plotësim i pasaktë i formularëve statistikor të dërguar pranë SHSSH nga Drejtoritë Rajonale, ç'ka ka sjell vështirësi nga ana jonë për mbylljen e analizave statistikore periodike në afatin e duhur, duke na detyruar të kërkojmë informacion shtesë herë pas here.

- Tek formularët statistikor të NE do të ishte një saktësim i të dhënave nëse fondi 6% do të jepej në tabelë më vete, ç'ka ka sjellë mos përputhje të dhënash në SHSSH, si pasojë kjo e mosdaljes të udhëzimeve në zbatim të Ligjit Nr. 57/2019 dhe VKM-së Nr.597/2019.
- Pandemia covid-19 rriti numrin e familjeve në nevojë që trajtohen me ndihmë ekonomike.
- Lidhur me shpërndarjen e bonusit të bebes SHSSH ka hasur disa problematika siç ka qënë:
 - a) Mungesa e informacionit të përfituesve të bonusit për dokumentacionin shoqërues për marrjen e çekut.
 - b) Zyrat e gjendjeve civile në të gjithë vendin plotësonin jосakatësisht përshkrimin e certifikatave të nevojshme për marrjen e çekut dhe mos informimin e qytetarëve për shpërndarjen e çeqeve sipas qarqeve etj. Këto problematika kanë bërë në shumë raste përfituesit janë kthyer disa herë për të plotësuar dokumentacionin ose duke shkuar në adresën e SHSSH.

PROPOZIM

Për shkak të problematikave të hasura gjatë vitit 2021 në formularët statistikor të NE do të ndihmonte një shtojcë shpjeguese e treguesve statistikorë për të shmangur problematikat e paraqitura më sipër, unifikimi i formularëve të dërguara për NE dhe PAK dërguar pranë DPSHSSH nga DR.

V. DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË BRENDSHME

Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme ka ushtruar veprimtarinë në përputhje me planin vjetor të miratuar nga Drejtori i përgjithshëm në tri sektorët e saj si më poshtë.

I. SEKTORI I SHËRBIMEVE TË BRENDSHME

OBJEKTIVI I

MIRËMENAXHIMI I ÇËSHTJEVE TË BURIMEVE NJERËZORE NË INSTITUCION

Në mënyrë krahasimore, gjatë vitit 2021, Sektori i Burimeve Njerëzore ka kryer veprimtarinë e tij sipas rezultateve konkrete të parashtruara më poshtë:

| Emërimë | | | | |
|---|-----------|-----------|-----------|-----------|
| | Viti 2021 | Viti 2020 | Viti 2019 | Viti 2018 |
| Emërimë gjithsej (konkurse DAP dhe SHSSH) | 194 | 41 | 46 | 39 |

| Lirime | | | | |
|-----------------|-----------|-----------|------|------|
| | Viti 2021 | Viti 2020 | 2019 | 2018 |
| Lirime gjithsej | 69 | 30 | 38 | 26 |

| Masa disiplinore | | | | |
|-------------------------|-----------|-----------|-----------|-----------|
| | Viti 2021 | Viti 2020 | Viti 2019 | Viti 2018 |
| Masa disiplinore | 6 | 4 | 2 | 6 |

| Shpallje të vendeve vakante | | | | |
|---|-----------|-----------|-----------|-----------|
| | Viti 2021 | Viti 2020 | Viti 2019 | Viti 2018 |
| Shpallje të vendeve vakante gjithsej | 85 | - | - | - |

| Kthim përgjigje dhe shkresa të llojeve të ndryshme | | | | |
|---|-----------|-----------|-----------|-----------|
| | Viti 2021 | Viti 2020 | Viti 2019 | Viti 2018 |
| Kthim përgjigje dhe shkresa gjithsej | 111 | - | - | - |

Tabela e mësipërme paraqet në mënyrë krahasimore të gjithë veprimtarinë e Sektorit të Shërbimeve të Brendshme ndër vite. Numri i emërimeve në vitin 2021 ka pësuar një rritje të

jashtëzakonshme si rrjedhojë e shtrirjes së skemës së vlerësimit bio-psiko-social të aftësisë së kufizuar në Qarkun Elbasan, Durrës dhe Korçë, si edhe për shkak të funksionimit prej disa vitesh të Programit të Ekselencës dhe Praktikave të Punës në administratën publike.

Numri i lirimeve vit pas viti ka ndryshuar dhe pjesa më e madhe e lirimeve janë kryer me vullnetin e vetë punonjësve.

II. SEKTORI JURIDIK

OBJEKTIVI I

NDJEKJA E PROCESEVE GJYQËSORE KU SHSSH ËSHTË PALË E PADITUR

Gjatë vitit 2021 Shërbimi Social Shtetëror ka qenë pjesë e 16 proceseve gjyqësore si palë e paditur nga të cilët 9 procese janë çelur gjatë vitit 2021, 7 kanë qenë procese gjyqësore në vijimësi. Këto procese gjyqësore janë mbi çështjet si më poshtë vijon:

- 2 procese për largime nga puna, të cilat janë ende në proces;
- 7 procese gjyqësore për kundërshtim të vendimeve të KMCAP-it, nga të cilat 3 janë fituar nga SHSSH dhe 4 janë ende në proces;
- 6 procese gjyqësore që kanë pasur si objekt kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, 5 janë në proces ndërsa për 1 rast është pushuar çështja;
- 3 procese gjyqësore me objekt pagim detyrimi;
- 1 proces gjyqësor me objekt njohje dhe trajtim të statusit të jetimit;

Në tërësi janë 9 procese gjyqësore në vazhdim, 4 procese të fituara nga SHSSH, 1 proces është pushuar me vendim gjykate dhe për 2 procese është pranuar pjesërisht kërkesë padia.

| Procese gjyqësore të fituara nga SHSSH | | | |
|--|-----------|-----------|-----------|
| Viti 2021 | Viti 2020 | Viti 2019 | Viti 2018 |
| 4 | 3 | 7 | 4 |

OBJEKTIVI II

ORGANIZIMI I MBLEDHJEVE TË KOMISIONIT NË ZBATIM TË LEGJISLACIONIT PËR PËRJASHTIMIN DOGANOR PËR PERSONAT QË GËZOJNË STATUSIN E PARA-TETRAPLEGJISË

Gjatë vitit 2021, Sektori Juridik pranë Shërbimit Social Shtetëror ka pajisur me vërtetim për përjashtim nga detyrimet doganore të automjeteve në pronësi të 24 personave me status para/tetraplegjie.

Në tabelën më poshtë jepet krahasimi ndër vite:

| Viti | Nr. vërtetimesh |
|------|-----------------|
| 2019 | 14 |
| 2020 | 24 |

Përveç komisioneve për pajisjen me vërtetim zhdoganimi janë sqaruar mbi procedurat qytetarë e paraqitur në institucion, si edhe janë sqaruar 2 qytetarë me e-mail zyrtar.

Shifrat kanë ardhur në rënie, si rezultat i kontrolleve nga ana jonë mbi përdorimin e makinave vetëm për lëvizjen e personave të sëmurë dhe jo për qëllime familjare të të afërmeve të personave me status para/tetraplegjie.

OBJEKTIVI III

SHQYRTIMI I KONTRATAVE DHE MARRËVESHJEVE TË BASHKËPUNIMIT TË LIDHURA MES SHSSH, INSTITUCIONEVE TË VARËSISË OSE OJF-VE NË FUSHËN E SHËRBIMEVE SHOQËRORE

Gjatë vitit 2021 Sektori Juridik pranë Shërbimit Social Shtetëror ka nënshkruar disa kontrata si më poshtë vijon:

- Kontrata e telefonisë;
- Kontrata e larjes së makinës së institucionit;
- Kontrata e shërbimit me roje private.

Është ndjekur procedura e tenderimit për rikonstruksionin e zyrave të Drejtorisë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Durrës, janë hartuar dokumentat standarde të tenderit dhe janë publikuar në APP, është kryer njoftimi i fituesit dhe njoftimi i lidhjes së kontratës.

Gjithashtu, gjatë vitit 2021 është rishikuar Marrëveshja e Bashkëpunimit për ndihmën juridike falas me Ministrinë e Drejtësisë.

OBJEKTIVI IV

SHPËRNDARJE PËR NJOHJE DHE ZBATIM I AKTEVE LIGJORE/NËNLIGJORE NË FUSHËN E SHËRBIMEVE SHOQËRORE

i. Shpërndarja e bazës ligjore

Gjatë vitit 2021 përmes monitorimit të Fletores Zyrtare janë shpërndarë për njohje dhe zbatim:

- 5 Urdhra;
- 3 VKM;

Përveç shpërndarjes për njohje dhe zbatim në strukturat e SHSSH, kjo bazë ligjore është përditësuar në faqen e web-it të SHSSH. Gjatë të gjithë vitit 2021 Sektori Juridik pranë Shërbimit Social Shtetëror ka trajtuar 48 shkresa të llojeve të ndryshme (sqaruese, interpretuese).

Gjatë vitit 2021 është hartuar Rregullorja e Grupit të Monitorimit lidhur me sjelljen e punonjës gjatë fushatës elektorale për zgjedhjet e Kuvendit të Shqipërisë.

III. SEKTORI I PROJEKTEVE

Sektori i Projekteve ka si mision sigurimin e ciklit të përgatitjes së projekteve sipas nevojavesi edhe garantimin e transparencës së veprimtarisë së Shërbimit Social nëpërmjet komunikimit transparent dhe ndërveprues me strukturat e varësisë, median, partnerët dhe publikun e gjerë.

OBJEKTIVI I

NDJEKJA E CIKLIT TË PROJEKTEVE

i. Projektet

Gjatë vitit 2021, mbështetur në një thirrje për projekte nga BE, Sektori i Projekteve në bashkëpunim me specialistët e shërbimeve sociale, organizatën “Ndihamoni Jetën” dhe Bashkinë Berat. Aplikimi u krye në datë 21 Janar 2021 dhe në Maj 2021 nuk u aprovua kalimi në fazën tjetër për shkak të mos përmbushjes së kriterit të aplikimit ku lider në projekt propozim duhet të ishte një OJF ose Bashki dhe jo SHSSH si institucion qendror.

Në bashkëpunim me Shoqatën “Ryder Albania”, Shërbimi Social Shtetëror është angazhuar në implementimin e projektit “Të bëjmë të mundur shërbimin në banesë për moshën e tretë” ku është dhënë ekspertizë mbi modelin, si edhe janë kryer 8 prezantime në 8 Bashkitë kryesore të vendit (Durrës, Elbasan, Shkodër, Kukës, Berat, Fier, Korçë, Vlorë) gjatë muajit Dhjetor 2021.

ii. Aktivitete të koordinuara nga Sektori i Projekteve

Gjatë vitit 2021 Sektori i Projekteve ka koordinuar dhe marrë pjesë disa aktivitete të ditëve të shënuara. Konkretisht:

- 1 Tetor - Dita Ndërkombëtare për të Moshuarit;
- 25 Nëntor – 10 Dhjetor - Ditët e aktivizimit kundër dhunës ndaj gruas;
- 3 Dhjetor - Dita Ndërkombëtare e Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Festat e Fundvitit.

OBJEKTIVI II

THELLIMI I TRANSPARENCËS SË AKTIVITETIT TË SHSSH

iii. Zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga Programi i Transparencës

Gjatë vitit 2021 mbështetur me kërkesat e Ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” është bërë transparente veprimtaria e Shërbimit Social Shtetëror përmes përditësimit të faqes zyrtare të web-it dhe komunikimit në rrjetet sociale.

Arritje konkrete gjatë vitit 2021:

- Janë publikuar 12 Buletine Informative dhe 12 Buletine të Donacioneve, të cilat pasqyrohen çdo muaj brenda datës 10 në faqen zyrtare të SHSSH;

- Është bërë përditësim i Regjistrit të Kërkesave dhe Përgjigjeve çdo 3 muaj, si edhe Regjistri vjetor përfundimtar më datë 10.01.2022;
- Janë përditësuar rubrikat e raporteve çdo 2 muaj dhe rubrikat e legjislacionit dhe njoftimeve sipas rasteve;
- Janë mbajtur të përditësuara çdo ditë rrjetet sociale zyrtare me postime rreth veprimtarisë së Drejtorisë së Përgjithshme, Drejtorive Rajonale dhe Institucioneve të Përkujdesit Shoqëror.

Koordinatori për të Drejtën e Informimit në SHSSH ka kthyer 56 përgjigje pa pagesë kërkesave për informacion drejtuar institucionit nga gazetarë investigativë, qytetarë, organizata apo grupe interesi. Në të gjitha rastet janë respektuar standardet ligjore të transparencës dhe afati i kthimit të përgjigjes prej 14 ditësh.

Në mënyrë krahasimore, numri i kërkesave për informacion të cilave u është kthyer përgjigje nga Koordinatori për të Drejtën e Informimit është si më poshtë:

| Kërkesat për informacion të trajtuara nga SHSSH | | | |
|--|-----------|-----------|-----------|
| Viti 2021 | Viti 2020 | Viti 2019 | Viti 2018 |
| 56 | 66 | 85 | 110 |

Numri i kërkesave përgjatë viteve ka ardhur në ulje, pasi qytetarët kanë pasur më shumë mundësi të informohen edhe përmes rrjeteve sociale zyrtare të SHSSH.

iv. Marrëdhëniet me publikun

Gjatë vitit 2021 Sektori i Projekteve ka punuar për trajtimin e të gjitha ankesave dhe kërkesave të qytetarëve për problematika të ndryshme dhe vendosjes së urave të bashkëpunimit me institucionet përkatëse për kthimin e përgjigjes qytetarit brenda afateve ligjore.

Arritje konkrete sipas tabelës më poshtë:

| Sqarime/kthim përgjigje zyrtare të ndara sipas burimit | | | | |
|---|------------------------|--------|---------------------|----------------------------|
| Viti | Rrjete Sociale Zyrtare | E-mail | Telefon/Institucion | Portali i Bashkëqeverisjes |
| 2021 | 431 | 154 | 592 | 1120 |
| 2020 | 690 | 47 | 129 | 1490 |

Krahasuar me vitin 2020 ankesat në Portalin e Bashkëqeverisjes dhe në rrjetet sociale zyrtare janë ulur kryesisht për shkak të kalimit të periudhës së mbylljes nga pandemia pasi “Kanali i Urgjencës” që ka ekzistuar gjatë pandemisë është mbyllur.

v. Monitorimi i medias

Gjatë vitit 2021 janë identifikuar dhe trajtuar 22 raste mediatike. Niveli i rasteve mediatike të identifikuara dhe trajtuara përgjatë viteve ka ardhur duke u ulur për shkak të komunikimit dhe

sqarimit të gazetarëve përpara se rastet të dalin në media. Tabela më poshtë paraqet të dhënat në mënyrë krahasuese për numrin e rasteve mediatike ndër vite.

| Raste mediatike të trajtuara në SHSSH | | | |
|--|-----------|-----------|-----------|
| Viti 2021 | Viti 2020 | Viti 2019 | Viti 2018 |
| 22 | 110 | 87 | 93 |

Në kuadër të ankesave të qytetarëve drejtuar SHSSH, Koordinatori për të Drejtën e Informimit ka realizuar 2 prononcime për median e shkruar dhe 2 reagime në TV.

OBJEKTIVI III NDËRTIMI I PARTNERITETEVE

vi. Marrëdhëniet me botën akademike dhe rrjetin e vullnetarëve të SHSSH

Shërbimi Social Shtetëror ka përpiluar një marrëveshje të re bashkëpunimi me Universitetet publike dhe private për realizimin e praktikave mësimore që prej vitit 2020. Për shkak të kujdesit për shëndetin e përfituesve të IPSH që prej fillimit të vitit 2021 u është dërguar e-mail universiteteve lidhur me pezullimin e përkohshëm të praktikave mësimore. Pavarësisht kësaj kemi pritur 4 studentë për praktika dhe për shkak të nevojës së IPSH vetëm 1 prej tyre është sistemuar për praktikë.

E njëjta situatë është e vlefshme edhe për kërkesat për vullnetarizëm të cilat janë pritur në e-mail zyrtar të SHSSH. Ka pasur 4 kërkesa për vullnetarizëm, të cilëve u është shpjeguar se për momentin nuk mund të aktivizohen në IPSH si pasojë e Covid-19, por që do të mbahen në Regjistrin e Vullnetarëve për të ardhmen. Regjistri i Vullnetarëve është i plotë, i përditësuar, duke pasqyruar në mënyrë të plotë gjeneralitetet dhe profesionet.

VI. DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka në fokus të punës së saj zhvillimin e shërbimeve shoqërore sipas legjislacionit përkatës. Kjo drejtori për vitin 2021 ka hartuar planin e veprimit me objektiva të matshme. Qëllimi i këtij plani orientues dhe zhvillues është rritja e cilësisë së shërbimeve sociale të ofruara për grupet vulnerabël në zbatim të strategjisë së mbrojtjes sociale.

OBJEKTIVI I: ZHVILLIMI I SHËRBIMEVE SHOQËRORE SIPAS STRATEGJISË KOMBËTARE

Për arritjen e këtij objekti u realizuan aktivitetet:

- Në kuadër të zbatimit të planit të deinstitutionalizimit, SHSSH është pjesë e bashkëpunimit me MSHMS dhe NJVQV për implemetimin e planit të veprimit. Partnerët e organizatave jofitimprurëse kanë përfunduar faza e parë të projektit dhe janë në fazën e pilotimit të shërbimit në dy shtëpi fëmije, Korçë dhe Vlorë. Janë bërë vlerësimet e fëmijëve dhe familjeve potenciale për rikthim në familje. Potencial për rikthim në familje janë vlerësuar 25 raste, nga të cilat 7 raste janë rikthyer gjatë vitit 2021 në kuadër të ndjekjes dhe mbështetjes së familjeve nga projektet e organizatave partnere me fokus deinstitutionalizimi.
- Dy institucionet e përkujdesit social për fëmijë në Bashkinë Vlorë dhe Korçë në kuadër të procesit të Deinstitutionalizimit janë mbështetur ndërmjet organizatave partnere dhe Fondit Social të dhënë nga MSHMS për të kaluar nga një shërbim rezidencial në një shërbim komunitar.
- Takime monitoruese me punonjësit e Drejtorive Sociale të Bashkive dhe Drejtorive Rajonale të SHSSH për implementimin e planeve sociale dhe zbatimin e legjislacionit në fushën sociale; Nga këto takime ka rezultuar që:
 - 60 bashki kanë hartuar planin social përveç Bashkisë Memaliaj;
 - Vlefshmëria e Planit Social për Bashkinë Dibër ka mbaruar në vitin 2020. Për 2021 kjo bashki ka qenë pa plan social;
 - Janë ngritur 7 NJVNR në nivel bashkie dhe njësi administrative, konkretisht në nivel bashkie (Maliq, Mallakastër, Gjirokastër, Vlorë, Mat) dhe në nivel njësi administrative (Tiranë, Elbasan).
 - Bashkitë kanë mungesë të theksuar të burimeve njerëzore për punonjës të shërbimeve sociale. Në 61 bashki ka vetëm 37 punonjës socialë.
 - Nga 61 Bashki, në 29 janë ngritur Drejtoritë e Shërbimeve Sociale dhe 32 bashki funksionojnë si sektor social.
- Janë realizuar raporte dhe plane veprimi të ndryshme sipas Strategjive përkatëse:
 - *Raportimi mbi realizimin e objektivave dhe detyrave të përcaktuara në planin e veprimit të Strategjisë për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.*
 - *Raporti vjetor mbi luftën kundër trafikimit të qenieve njerëzore.*
 - *Raportimi vjetor mbi Kartën Sociale*

- *Raportim mbi Strategjinë e Moshimit.*
- Në zbatim të Ligjit Nr 121/2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Shqipëri” Drejtoria e Shërbimeve Sociale në bashkëpunim me Organizatën PNUD ka realizuar “Raportin e Vlerësimit të Nevojave Sociale” për vitin 2021. Ky raport është përgatitur mbi bazën e të dhënave të mbledhura për herë të parë drejtëpërdrejtë nga Bashkitë nëpërmjet burimeve të të dhënave administrative të cilat mundësuan:
 - *Të dhënat mbi shërbimet shoqërore dhe shpërndarja e tyre në nivel kombëtar, rajonal dhe lokal.*
 - *Të dhënat mbi shërbimet sipas llojit, mënyrës së menaxhimit, financimit, tipologjisë së shërbimeve dhe grupeve përfituese.*
 - *Të dhëna mbi shkallën e plotësimit të nevojës për shërbime sipas grupeve në situatë kritike, sipas rajoneve dhe bashkive të vendit.*
- Bazuar në strategjinë kombëtare për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm në Gusht të vitit 2021 u rihap Qendra Pritëse e Trajtimit të Rasteve të Rikthyer nga Zonat e Luftës Siria dhe Iraku. Shërbimet që ofron qendra janë trajtimet e specializuara për traumat dhe lehtësimi për jetesë të pavarur dhe ndërgjegjësimi për të jetuar në komunitet. Në dhjetor 2021 të gjitha rastet u integruan në komunitet.
- Ndjekja dhe Mirëadministrimi i Regjistrimit Elektronik të Shërbimeve Shoqërore. Për 2021 SHSSH vazhdon të identifikojë të njëjtat problematika për Regjistrimin Elektronik si në vitet e kaluara. Ndërmjet zyrave rajonale të SHSSH është grumbulluar informacioni se stafet e bashkive janë trajnuar dhe kanë hedhur të dhëna gjatë kohës së trainimit. Bashkitë kanë ende problematika teknike dhe nuk e kanë të mundur të gjenerojnë në mënyrë masive rastet aplikuese. Nga informacioni i grumbulluar raportohet se për vitin 2021 asnjë bashki nuk gjeneron më të dhëna në Regjistrim. Për shkak të shumë problematikave në sistem bashkitë nuk kanë vazhduar të përdorin Regjistrimin Elektronik për menaxhimin e rasteve sociale.
- Është realizuar mbledhja dhe përpunimi i të dhënave të shërbimeve shoqërore për çdo bashki, në bashkëpunim me punonjës të DRSHSSH për përditësimin e hartës së shërbimeve sociale në nivel Bashki/Qark në lidhje me IPSH-të e fëmijëve, të moshuarve, të personave me aftësi të kufizuara, të trafikimit, të dhunës, komunitare dhe të emergjencave.

Nga të dhënat e Drejtorive Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror raportohet se janë 244 qendra të cilat ofrojnë shërbime sociale për kategori të ndryshme. Gjatë vitit 2021 janë hapur 16 shërbime të reja sociale për të gjithë target grupet në nevojë. Këto shërbime kanë një shtrirje gjeografike në të gjithë vendin.

OBJEKTIVI II: PËRKUJDESJE SOCIALE ME STANDARDE TË PËRMBUSHURA

DSHS në SHSSH për realizimin e këtij objekti ka planifikuar dhe realizuar aktivitetet si më poshtë:

2.1 Monitorimi i IPSH-ve sipas kalendarit të miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm

Për vitin 2021 në bazë të problematikave të veçanta që janë evidentuar gjatë ofrimit të shërbimit në IPSH-të për target grupet në nevojë janë monitoruar 10 institucione. Problematikat lidhen kryesisht për mungesën e burimeve njerëzore, plotësimin e nevojave në infrastrukturë. Qëllimi i monitorimit të institucioneve ka qenë dhe bashkëpunimi ndërinstytucional me pushtetin lokal dhe familjen biologjike në lidhje me përmbushjen e nevojave të përfituesve dhe respektimin e të drejtat të tyre.

Drejtoria e Shërbimeve Shoqërore në fokus të punës së saj ka pasur edhe monitorimin e qendrave që ofrojnë shërbime me fonde të buxhetit të shtetit. Konkretisht janë monitoruar 12 Qarqe dhe 14 Bashki. Këto qendra ofrojnë shërbime për të gjithë kategoritë në nevojë dhe kanë një shpërndarje të gjerë në të gjithë vendin.

2.2 Përpunimi i të dhënave statistikore 4 mujore të IPSH dhe analiza e dinamikës së përfituesve

- Komisionim i kujdesshëm për të gjitha tipologjitë e shërbimit në IPSH

Vlerësimi i kujdesshëm i kërkesave për sistemin në IPSH duke argumentuar interesin më të mirë të çdo përfituesi për marrjen e shërbimit pranë familjes, ka qenë fokus i punës së 4 komisionëve të ngritura në SHSSH për vlerësimin e nevojave për sistemin në IPSH të fëmijëve, të moshuarve, personave me aftësi të kufizuara dhe status jetimi.

- Në vitin 2021 janë sistemuar 9 raste me AK në institucionet për persona me aftësi të kufizuara, ndërsa për vitin 2020 janë komisionuar 6 persona me AK (tabela nr.1). Kryesisht këto raste vijnë nga familje në kushte të vështira social-ekonomike dhe kanë mungesë të ofrimit të shërbimeve komunitare ose ditore pranë zonave të vendbanimit. Për vitin 2021 vihet re rritje të kërkesave kryesisht mbi moshën 21 vjeç të personave me AK.
- Gjatë vitit 2021 janë komisionuar 36 fëmijë (10 nga SHSSH, 26 raste emergjente nga GTN dhe Bashkitë). Gjatë vitit 2020 janë sistemuar në IPSH-të publike rezidenciale 47 fëmijë (22 nga SHSSH, 25 si raste emergjente nga GTN dhe Bashkitë). Nisur sa më sipër rezulton se kemi një ulje të numrit të fëmijëve në IPSH publike (tabela nr.1).
- Gjatë 2021 janë sistemuar në Shtëpitë e të Moshuarve 68 raste, ndërsa në vitin 2020 janë sistemuar 42 të moshuar. Krahasur me vitin 2020 kemi rritje të kërkesave për shërbime rezidenciale nga të moshuarit (vitin 2020-120 kërkesa dhe viti 2021-136 kërkesa). Bazuar në vlerësimet social-ekonomike të pushtetit vendor rezulton se kjo rritje vjen si rrjedhojë e braktisjes nga të afërmit, dhe pamjaftueshmëria e të ardhurave për të përballuar jetesën.
- Gjatë vitit 2021 në përputhje me Ligjin Nr. 8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit” kanë përfituar Statusin e Jetimit 180 persona, nga të cilët 46 me prindër të vdekur dhe 132 fëmijë të lindur jashtë martesë. Këtë vit kemi edhe raste të fëmijëve të

ciët kanë përfituar statusin e jetimit që ju është hequr e drejta prindërore me Vendim Gjykatë. Për vitin 2021 kemi një rënie të kërkesave të përfitimit të statusit të jetimit për fëmijë të lindur jashtë martese ndërkohë kemi një rritje të kërkesave për fëmijë të cilët janë në kujdestarinë e njërit nga prindërit dhe tjetri nuk jeton (tabela nr.3).

- Në QKTE gjatë vitit 2021 janë trajtuar 40 familje (168 banorë). Në 2020 janë trajtuar 47 familje dhe 174 banorë. Në sajë të bashkëpunimit me Bashkinë e Tiranës, me institucionet e punësimit dhe formimit profesional, institucionet e arsimit dhe edukimit si kopshte, shkolla e çerdhe janë integruar në komunitet 4 familje.
- Gjatë vitit 2021 në QKPVT janë trajtuar 12 raste, ndërkohë që për vitin 2020 janë trajtuar 15 raste.
- Gjatë vitit 2021 në QKPVDHF janë trajtuar 85 raste ku 76 janë raste të reja ndërkohë që janë integruar 67 raste.

2.3 Të dhënat e përfituesve në Institucionet Rezidenciale për personat në nevojë


Në fund të vitit 2021, në 30 institucionet të përkujdesit shoqëror publike, rezidenciale dhe ditore kanë marrë shërbim **1140 persona**. Krahasuar me vitin 2020 numri i përfituesve në IPSH nuk ka ndryshim (IPSh rezidenciale, ditore, dhe individë në QKTE).

Tab nr 1. Numri i përfituesve në Ipsh rezidenciale publike në vite.

| Nr. i përfituesve | Viti 2019 | Viti 2020 | Viti 2021 |
|----------------------------------|-----------|---------------------------|---------------------------|
| Totali personave PAK IPSH | 194 | 194 | 19 |
| Totali fëmijëve IPSH publike | 218 | 229 | 215 |
| Totali personave të moshuar IPSH | 318 | 301 | 300 |
| QKPVT | 18 | 10 | 15 |
| QKTVDHF | 91 | 60 (34 gra dhe 36 fëmijë) | 85 (35 gra dhe 47 fëmijë) |

| | | | |
|------|---------|---------|---------|
| QKTE | 42 | 47 | 40 |
| | familje | familje | familje |
| | dhe 166 | dhe 174 | dhe 168 |
| | persona | banorë. | banorë |


Grafik.1. Numri i përfituesve në IPSH rezidenciale publike sipas tipologjisë.



Tab. nr 2 Numri i përfituesve që marrin shërbim ditor në Ipsh-ët publike.

| IPSH Ditore | Viti 2019 | Viti 2020 | Viti 2021 |
|--------------|-----------|-----------|-----------|
| PAK DITOR | 60 | 59 | 76 |
| FEMIJE DITOR | 57 | 34 | 24 |
| MOSHUAR | 66 | 80 | 65 |
| Total | 202 | 173 | 165 |


Grafik. Nr 2. Numri i përfituesve që marrin shërbim ditor në IPSH-të publike.



Gjatë vitit 2021 nga IPSH-të publike për fëmijë janë rikthyer në familje biologjike 20 fëmijë dhe 2 persona me AK. Janë birësuar 13 fëmijë nga IPSH publike. Për vitin 2020 janë rikthyer në familje biologjike 12 fëmijë dhe 3 PAK, janë birësuar 27 fëmijë nga IPSH-të publike. **Sipas të dhënave statistikore të dy viteve të fundit rezulton se ka një rritje të numrit të fëmijëve të birësuar.**

Gjatë vitit 2021 janë pranuar në IPSH-të rezidenciale sipas mekanizmit të mbrojtjes së fëmijës nga ekipet multidisiplinare të ngritura nëpër Bashki janë sistemuar 26 raste emergjente në bazë të ligjit nr.18/2017 “Për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve në Republikën e Shqipërisë”, ndërsa gjatë viti 2020 janë vendosur në IPSH - të publike rreth 49 fëmijë. SHSSH ka ndjekur 20 raste fëmijësh gjatë vitit 2021 në proçese gjyqësore.

Grafik nr 3. Rikthimet në familje, birësimet dhe kujdestaria e fëmijëve në IPSH-të publike



Grafik nr 4 . Rastet e Viktimave të Dhunës në Familje të trajtuara në QKTVDHF




Tabela nr.3 Pranimet me komision nga SHSSH dhe nga mekanizmat e referimit të VT/VMT dhe rastet e dhunës.

| Nr | Institucionet | Viti 2019 | Viti 2020 | Viti 2021 |
|----|----------------------------|---------------------|---------------------|---------------------|
| 1 | IPSH për PAK | 5 persona | 6 persona | 9 persona |
| 2 | IPSH për fëmijët | 57 fëmijë | 45 fëmijë | 10 fëmijë |
| 3 | IPSH për të moshuarit | 66 të moshuar | 42 të moshuar | 68 të moshuar |
| 4 | Statusi jetim | 202 raste me status | 127 raste me status | 180 raste me status |
| 5. | VT/VMT | 18 raste | 10 raste | 12 raste |
| 6. | Raste të dhunës në familje | 91 raste | 60 raste | 85 raste |

OBJEKTIVI III: MIRËMENAXHIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Drejtorja e Shërbimeve Sociale në planin e veprimit për vitin 2021 në realizimin e objektivit për mirëmenaxhimin e burimeve njerëzore e ka fokusuar punën e vet duke bashkëpunuar dhe me organizatat e ndryshme në fushën e shërbimit social për të realizuar trajnime të ndryshme si për stafet sociale ashtu dhe për Drejtorinë e Shërbimeve Sociale në SHSSH-së me qëllim rritjen e performancës së punonjëve. Kjo sjell rritjen e cilësisë së shërbimit nga ofruesit e shërbimeve dhe arrijten sa më të lartë të objektivave të Strategjisë së Mbrojtjes Sociale. Konkretisht janë realizuar trajnime në bashkëpunim me organizatat jofitimprurëse si si më poshtë:

- Trajnimi i stafit të Qendrave të Zhvillimit mbi temën “Mekanizmat institucionale për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

- Trajnimi i stafit të sektorit social të IPSH-ve PAK “Identifikimi dhe menaxhimi i sjelljeve të pa përshtatshme tek fëmijët me autizëm”.
- Trajnimi i specialistëve të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale mbi temën “Fëmijëria e Hershme: Strategjitë dhe veprimet për një komunitet të Përkujdesit”
- Trajnimi i specialistëve të Drejtorisë së Shërbimeve Sociale mbi temën “Stimulimi mbi menaxhimin e rasteve të fëmijëve VT/VMT” nga OSBE.
- Trajnimi i stafëve të DRSHSSH dhe Bashkive mbi temën “Shërbimi i Asistencës Shtëpiake për moshën e tretë”.
- Trajnimi i stafëve të IPSH-ve mbi temën “Fuqizimi i përgjigjes së sektorit të shërbimeve të kujdesit shoqëror ndaj dhunës në familje e dhunës me bazë gjinore” organizuar nga UNDP dhe MSHMS.
- Trajnimi i stafëve sociale të Shtëpive të të moshuarve me temë: “Për një moshim të shëndetshëm” nga YMCA.
- Implementimi i metodologjisë HEART në IpsH-të për fëmijë, organizuar nga Save dhe Children.
- Ërkshop me temë “Ribashkimi i fëmijës me familjen, progresi dhe mundësitë për zhvillimi dhe parandalimi i ndarjes” organizata ARSIS.
- Procesi i deinsitucionalizimit në Shqipëri, arritjet dhe sfidat, Ërkshop me IPSH-të për fëmijë dhe organizata dhe institucionet partnere.

OBJEKTIVI IV: PËRFSHIRJA E GRUPEVE VULNERABËL

Zhvillimet e shërbimeve të kujdesit social, bazohen në parimet e decentralizimit dhe deinsitucionalizimit, për përfshirjen e grupeve vulnerabël në programet e mbrojtjes sociale si dhe inkurajon pjeësmarrjen e plotë dhe efektive në shoqëri. Konkretisht si rrjedhojë janë realizuar si më poshtë:

- I gjithë programi i mbrojtjes sociale do të ofrohet dhe monitorohet nëpërmjet një sistemi të dixhitalizuar në të gjithë vendin. Kjo për të patur më shumë transparencë dhe efikasitet. Lidhur me Regjistrin Elektronik të Shërbimeve Shoqërore është realizuar trajnimi i gjithë stafit të njësisve vendore, Drejtorive Rajonale të SHSSH-së dhe Drejtorisë së Shërbimeve Sociale në SHSSH. Aktualisht është bërë i mundur popullimi i regjistrit nga njësitë vendore, por problematikat janë të shumta. Një pjesë e bashkive kanë problematika teknike dhe nuk e përcjellin informacionin pranë Drejtorive Rajonale të SHSSH-së. Drejtoritë Rajonale nuk kanë akses të shohin rastet e hedhura si dhe nuk mund t’i përcjellin në SHSSH. Në disa prej bashkive për arsye të problemeve teknike regjistri nuk funksionon.